



**Manuali i Mbikëqyrjes së
Bazuar në Rrezik për
Siguruesit**

Ekzaminimet në vend

K O R R I K 2 0 1 9



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit nr. 03/L-09 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 16 të Statutit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 83, paragrafi 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2019, miratoi këtë:

Manual i Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Siguruesit

Ekzaminimet në vend

Prishtinë, korrik 2019

BOTUES

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©
Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++383 38 222 055
Fax: ++383 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT

www.bqk-kos.org

AUTORË

Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Përmbajtja

1. Hyrje	7
2. Qëllimi i manualit	8
3. Procesi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik	9
3.1. Faza e parë - të kuptuarit e institucionit	10
SHTOJCA I – 1: MOSTRA (SHEMBULL) MBI NJOHURITË THEMELORE TË SIGURUESIT / INFORMATAT SPECIFIKE	10
SHTOJCA II – 2. MOSTRA (SHEMBULL) MBI PROFILIN E RREZIKUT TË SIGURUESIT (PROFILI I RREZIKUT) .12	
3.2. Faza e dytë - vlerësimi i rrezikut	12
3.2.1 KORNIZA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT - PËRMBLEDHJE	13
3.2.2 QËLLIMI I KORNIZËS	13
3.2.3 ELEMENTET E KORNIZËS	14
3.3. Procesi i vlerësimit të rrezikut – përmbledhje	14
3.3.1 HAPI 1: KUPTIMI I AKTIVITETEVE TË RËNDËSISHME TË SIGURUESIT	15
3.3.2 HAPI 2: KUPTIMI I RREZIQEVE TË QENËSISHME TË SIGURUESIT	16
3.3.3 HAPI 3: IDENTIFIKIMI I NIVELEVE TË RREZIKUT TË QENËSISHËM NË SECILËN PREJ AKTIVITETEVE TË RËNDËSISHME	17
3.3.4 HAPI 4: PËRCAKTIMI I KUALITETIT TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË SIGURUESI	18
3.3.5 HAPI 5: VLERËSIMI I KUALITETIT TË FUNKSIONEVE TË KONTROLLIT TE SIGURUESI	20
3.3.6 HAPI 6: VLERËSIMI I RREZIKUT NETO TË SIGURUESIT	21
3.3.7 HAPI 7: ZHVILLIMI I MATRICËS SË RREZIKUT PËR NJË SIGURUES	21
3.3.8 VEPRIMET POTENCIALE PËRCJELLËSE	22
3.4. Kategoritë e vlerësimit të rrezikut të përbërë	23
4. Faza e tretë - ekzaminimet në vend	26
4.1. Planifikimi dhe përgatitja	27
4.2. Llojet e ekzaminimeve	28
4.2.1 EKZAMINIMI I PLOTË	28
4.2.2 EKZAMINIMI ME FUSHËVEPRIM TË KUFIZUAR	30
4.3. Fushat e rrezikut për t’u ekzaminuar nga ekzamineret	30
4.4. Ekzaminimi në vend - parimet	32
4.5. Procesi i kompletimit të ekzaminimit në vend	33
5. Vlerësimi sipas sistemit CAMELS	49
5.1. Vlerësimi i përgjithshëm	49
5.1.1 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM 5	49
5.1.2 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM 4	49
5.1.3 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM 3	49

5.1.4 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM 2	49
5.1.5 VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM 1	50
5.2. Vlerësimi i komponentëve	50
5.2.1 MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT	50
5.2.2 CILËSIA E ASETETEVE	50
5.2.3 RISIGURIMI.....	51
5.2.4 MJAFTUESHMËRIA E REZERVAVE TEKNIKE.....	51
5.2.5 MENAXHMENTI	52
5.2.6 FITIMET.....	53
5.2.7 LIKUIDITETI	53
5.2.8 RREZIKU I TREGUT.....	54
6. Përcaktimi i shpeshtësisë së ekzaminimit	56
7. Faza e katërt: Letrat e punës së ekzaminimit.....	57
8. Faza e pestë – Raportimi	60
8.1. Shabllonet e raportimit.....	60
SHTOJCA 2 – MOSTËR (SHEMBULL) I FORMËS SË RAPORTIT TË EKZAMINIMIT.....	60
9. Hyrja në fuqi	75

1. Hyrje

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), është përgjegjëse për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare në Republikën e Kosovës, në përputhje me ligjet përkatëse. Një përgjegjësi e tillë, është e paraparë në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 23, paragrafi 1 si dhe Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet neni 4, paragrafi 2, përkatësisht për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, si dhe të subjekteve tjera që ushtrojnë aktivitetet e parashikuara me këtë ligj.

Sigurimin i një sistemi stabil, efikas dhe konkurrues të sigurimeve si dhe mbrojtja e interesave të policëmbajtësve janë objektivat kryesore të BQK-së, të cilat janë të përcaktuara në Nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-09 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe nenin 4, paragrafi 1 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet.

Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe strukturën organizative të saj, BQK-ja realizon përgjegjësitë mbikëqyrëse të industrisë së sigurimeve përmes Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (më tutje:DMS) i cili përbëhet nga Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend të Siguruesve (on-site) dhe Divizioni për Raportim dhe Analiza (off-site).

Në funksion të realizimit të përgjegjësisive të saj, BQK-ja harton dhe rishikon politikat, procedurat dhe praktikatat e saj mbikëqyrëse në mënyrë që të sigurojë një kornizë mbikëqyrëse dinamike, efikase, të strukturuar dhe të orientuar në rrezik. Rezultat i kësaj është miratimi dhe ushtrimi i qasjes së mbikëqyrjes të bazuar në rrezik në përputhje me nenin 83, paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit 05/L-045 për Sigurimet si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Manuali i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të siguruesve në vend ndihmon dhe lehtëson mbikëqyrjen e vazhdueshme të siguruesve nga stafi i Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (DMS), në kuadër të BQK-së dhe do të shfrytëzohet nga stafi i DMS-së si manual referues dhe udhëzues pune. Manuali mund të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të mbulojë zhvillimet dhe ndryshimet në industrinë e sigurimeve të Kosovës.

2. Qëllimi i manualit

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik është një proces i strukturuar, fleksibil dhe progresiv i krijuar që të identifikojë, vlerësojë, matë, monitorojë dhe kontrollojë/zvogëlojë faktorët kryesorë të rrezikut të cilëve u janë ekspozuar siguruesit individual dhe e gjithë industria e sigurimeve. Një qasje e tillë rrit efektivitetin e mbikëqyrjes duke mbështetur dhe forcuar vendimmarrjen përmes vlerësimit dhe adresimit të fushave të rreziqeve sipas rëndësisë së tyre dhe përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve në dispozicion të mbikëqyrjes. Qëllimi i këtij manuali është që të organizojë dhe formalizojë objektivat dhe procedurat mbikëqyrëse që ofrojnë udhëzime për ekzaminerët e sigurimeve të BQK-së, si dhe për të rritur cilësinë dhe zbatimin e vazhdueshëm të procedurave mbikëqyrëse.

Manuali ofron udhëzime specifike për përcaktimin dhe vendosjen e strategjisë mbikëqyrëse për çdo sigurues:

- Përcaktimin e procedurave që do të përdoren në ekzaminimin e të gjitha fushave të një siguruesi, duke përfshirë edhe ato procedura që do të mundësojnë zbulimin e hershëm të trendëve, që nëse vazhdojnë, mund të rezultojnë në përkeqësim të kushteve të siguruesit;
- Vlerësimin e përshtatshmërisë së praktikave dhe procedurave të institucionit për menaxhim të rrezikut, si dhe nivelin e pajtueshmërisë me to;
- Vlerësimin e performancës së përgjithshme dhe aktiviteteve të menaxhmentit dhe bordit të drejtorëve;
- Bazën për përgatitjen e letrave të punës që mbështesin konkluzionet e arritura dhe ndihmojnë në vlerësimin e punës së kryer;
- Përdorimin e kritereve objektive si bazë për konkluzionet e përgjithshme dhe për komentet dhe kritikën të cilat gjenden në raportin e ekzaminimit në lidhje me gjendjen dhe kualitetin e siguruesit dhe menaxhmentin e tij.

Ekzaminerët inkurajohen që të përdorin këtë manual si manual referues dhe si udhëzues pune. Në shumicën e seksioneve të manualit, janë ofruar procedurat që formojnë bazën e procesit mbikëqyrës të secilit sigurues në mënyrë individuale. Këto procedura kanë për qëllim që të çojnë në mbikëqyrje të vazhdueshme dhe objektive të secilit institucion. Ekzaminerët duhet të jenë në gjendje të rrisin nivelin e profesionalizmit dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar duke inkurajuar secilin sigurues që të përcjellë praktikën më të mira që ekzistojnë aktualisht në këtë industri. Megjithatë, në asnjë rast, kjo qasje nuk guxon të ndalojë zhvillimin dhe zbatimin e praktikave konceptualisht të shëndosha dhe inovative nga institucionet individuale. Objektivi i këtij manuali është që të krijojë një pikë referimi të rëndësishme për BQK-në, por nuk synon dhënien e të gjitha zgjidhjeve të gatshme që t'iu përshtatet të gjitha çështjeve të përditshme që do të hasen në mbikëqyrjen e siguruesve në Kosovë. Më saktë, synohet mbulimi i një game të gjerë çështjesh, në detaje të mjaftueshme për të lehtësuar qasjen praktike për çështje të ndryshme dhe të paparashikuara që mund të lindin. Gjatë zbatimit të këtij manuali mbeten në fokus konceptet themelore dhe parimet bazë në mbikëqyrjen e sigurimeve.

3. Procesi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik

Synimi i procesit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është që të zgjerojë dhe të nxisë identifikimin e rrezikut të pranishëm tek siguruesi dhe ta përdorë këtë vlerësim për formulimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të siguruesit. Procesi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik përfshinë identifikimin e rreziqeve domethënëse, vlerësimin dhe analizën e këtyre rreziqeve, dokumentimin e rezultateve të analizës dhe hartimin e rekomandimeve për mënyrën se si mund të zbatohet analiza në monitorimin e vazhdueshëm të siguruesit.

Metodologjia e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik e përqendron përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit financiar të siguruesit aty ku duhet – tek bordi drejtues dhe menaxhmenti i saj. Është përgjegjësi e siguruesit të ketë dhe t'i përmbahet politikave dhe praktikave të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut, për të zbutur rreziqet domethënëse që shoqërojnë biznesin.

Procesi i mbikëqyrjes është një cikël i plotë, një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

1. Të kuptuarit e institucionit – të kuptuarit e karakteristikave unike të institucionit, kulturës së korporatës dhe profilit të rrezikut të institucionit:
 - 1.1 Mbledhja dhe shqyrtimi i informacionit për siguruesin përfshirë raportet paraprake të ekzaminimeve;
 - 1.2 Shqyrtimi i pasqyrave financiare respektivisht analizave financiare dhe indikatorëve financiar nga off-site;
 - 1.3 Shqyrtimi i planit të biznesit, raporteve të auditorit të jashtëm dhe raporteve aktuaristike
 - 1.4 Shqyrtimi i çështjeve tjera të lidhura me aktivitetin e siguruesit;
2. Vlerësimi i rreziqeve të institucionit – fokusimi i përpjekjeve mbikëqyrëse mbi ato fusha që paraqesin rrezikun më të madh për sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të një institucioni në përputhje me profilin e siguruesit:
 - 2.1 Planifikimi dhe caktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse - zhvillimi i një plani që pasqyron shqetësimet e mbikëqyrjes, se si janë duke u adresuar ato apo si do të adresohen;
 - 2.2 Përkufizimi i aktiviteteve të ekzaminimit – detajimi i procedurave dhe veprimeve që do të kryhen; përcaktimi i informacioneve të kërkuara nga siguruesi lidhur me aktivitetin e ekzaminimit;
3. Ekzaminimi në vend (on-site) – testimi dhe verifikimi i të dhënave të ofruara nga institucioni;
4. Dokumentet e punës për ekzaminimin në vend - indeksimi i letrave të punës do të bëhet sipas fushave të ekzaminimit;
5. Raportimi - hapi final do të jetë komunikimi i gjetjeve dhe rekomandimeve për siguruesin e ekzaminuar dhe ndërmarrja e hapave përcjellës për veprimet e zbatimit apo planit të veprimit. Procesi i hartimit, dorëzimit dhe finalizimit të draft raportit të hartuar nga DMS-ja do bëhet në pajtim me nenin 89, Raporti i ekzaminimit të Ligjit Nr. 05/L -045 për Sigurime si dhe aktet tjera përkatëse.

Fokusi duhet të jetë në arritjen e një procesi të plotë dhe të koordinuar të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik. Përmbajtja dhe formati i dokumenteve të përgatitura janë fleksibil dhe duhet t'i

përshtaten praktikave të mbikëqyrjes të BQK-së, si dhe strukturës dhe kompleksitetit të institucioneve.

3.1. Faza e parë - të kuptuarit e institucionit

Objekti i të kuptuarit të institucionit përfshinë përditësimin e të dhënave lidhur me siguresin, profilin dhe praktikën e menaxhimit të rrezikut, si dhe zhvillimin e një strategjie mbikëqyrëse të përshtatshme për siguresin.

Përmbledhja mbi njohuritë themelore të siguresit duhet të përfshijë një përmbledhje që komunikon, në mënyrë koncize, informatat të cilat tregojnë gjendjen aktuale të siguresit dhe vënë në pah çështjet kryesore, duke përfshirë gjetjet dhe shqetësimet e ekzaminimeve të mëhershme. Përmbledhja duhet të ofrojë një pasqyrë të strukturës së siguresit, kushteve financiare dhe profilit aktual dhe të ardhshëm të rrezikut. Për më shumë, pasqyra do të përmbajë informata të cilat kanë të bëjnë me pronësinë, kapitalin dhe strukturën e grupit (aty ku është e zbatueshme), rrjetin e degëve, plotësimin me personel, sistemin e qeverisjes korporative, profilin afarist, strategjinë e siguresit, rreziqet, sfidat me të cilat përballlet institucioni, si dhe vlerësimet rregullative dhe vlerësimet e tjera.

Informatat për hartimin dhe përditësimin e përmbledhjes institucionale të siguresit duhet të mblidhen nga burimet e besueshme në dispozicion të ekzaminerëve. Këto burime do të përfshijnë raportet e ekzaminimeve në vend, raporteve të rregullta prudenciale dhe ligjore, raportet ad-hoc, rezultatet e publikuara financiare, takimet formale dhe joformale me bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë, auditorët e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe raportet dhe takimet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse/rregullatore.

Burimet e tjera të informacionit përfshijnë raportet e mediave, inteligjencën e tregut (informata rreth konkurrencës në treg), si dhe ankesat e paraqitura kundër siguresit. Të kuptuarit e institucionit në formë të përmbledhur është paraqitur në Shtojcën I-1 dhe Shtojcën I-2 si vijon:

Shtojca I – 1: Mostra (shembull) mbi njohuritë themelore të siguresit / informatat specifike

Datë: dita-muaji-viti

Emri i siguresit: xxxxxx

Adresa e siguresit: xxx, nr.xx, Prishtinë, Kosovë

Data kur janë zhvilluar njohuritë kryesore: dita-muaji-viti

Përgatitur nga: xxxxxx xxxxxx - ekzaminer përgjegjes për XXX

Azhurnimi i fundit: dita-muaji-viti

Profili i përgjithshëm i siguresit – përfshinë vlerësimet e ekzaminimit që paraqesin formën për aktivitetet e ardhshme mbikëqyrëse. Disa nga këto vlerësime janë përfshirë në këtë profil të njohurive të përgjithshme. Pasi të jetë përfunduar profili, përmbledhen të dhënat e pasqyruara këtu. Profili përditësohet, nëse është e nevojshme, në mes të ekzaminimit dhe çdo herë para fillimit të çdo ekzaminimi.

Historiku i siguruesit – përfshinë datën licencimit, datën e fillimit të aktivitetit, bashkimet apo përvetësimet, numrin e degëve, emrin dhe aktivitetet apo llojet e biznesit të filialeve, nëse filialet nuk janë në pronësi të plotë, përfshihen emrat dhe përqindja e pronësisë së pronarëve të tjerë.

Vlerësimet në vazhdimësi të mbikëqyrjes (ekzaminimeve) – përfshinë radhitjen e vlerësimeve sipas rreziqeve, përbërësit (notat) e vlerësimit për dy ekzaminimet e fundit dhe ndonjë çështje të rëndësishme, që ka kërkuar vëmendje të bordit apo menaxhmentit. Nëse ndonjë çështje e rëndësishme është identifikuar ose nëse siguruesi është nën ndonjë dokument veprimi të mbikëqyrjes, shënohen veprimet korrektuese të ndërmara për përcjellje nga mbikëqyrja. Nëse është në pronësi të huaj, përfshihen këtu informatat e marra nga mbikëqyresit e siguruesve amë.

Pronësia – përfshinë listën e aksionarëve të rëndësishëm, përqindjen e tyre të pronësisë, interesat kryesore në bizneset e tyre dhe ndonjë pozicion të mbajtur tek siguruesi (drejtor apo pozitë tjetër menaxhuese). Nëse aksionari është ndonjë sigurues tjetër apo entitet shërbyes financiar, shënohet nëse entiteti është në pronësi të huaj dhe nëse është kështu, pasqyrohet vendi i origjinës së pronësisë, mbikëqyrësi i tij i jashtëm dhe struktura e pronësisë, p.sh. a janë aksionet e saj të tregtuara publikisht, ndonjë aksionar të rëndësishëm.

Bordi dhe struktura e bordit – përfshinë drejtorët aktual, profesionet e tyre dhe funksionet e tyre në komitetet e bordit siç mund të jetë: komiteti i auditimit, komiteti i menaxhimit të rrezikut, komiteti i investimeve etj. Përshkruhet struktura e bordit, si: bordi menaxhues si dhe bordi ekzekutiv.

Pozitat kryesore menaxhuese dhe struktura organizative – përfshinë listën e 5-10 pozitave më të larta menaxhuese duke identifikuar individualisht se çka përfshijnë këto pozita, paraqitet në mënyrë të detajuar kompenzimi total për çdo pozitë kyçe dhe se si janë përcaktuar bonuset, performanca, rritja apo në bazë të vjetërsisë. Përshkruhet struktura dhe kultuara organizative, pra, a janë vendime të marra duke u bazuar në hierarki, komitete, apo në ndonjë mënyrë tjetër, a janë komunikime të hapura apo të kontrolluara, etj.

Sistemi i kontroleve të brendshme – përfshinë diskutimet mbi programin apo funksionin e sistemit të kontrollit të brendshëm të siguruesit, funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe ndërlidhjen e strukturës raportuese, siç mund të jetë me menaxhmentin, bordin ose komitetet e tij, mjaftueshmërinë e auditimit, fushëveprimin, testimin, si dhe paraqitet kompania e jashtme audituese e përfshirë. Paraqiten lokacionet e objekteve mbështetëse të teknologjisë informative, si dhe shërbimet e saj.

Qeverisja korporative e siguruesit dhe toleranca e rrezikut – përfshinë verifikimin se a është siguruesi refuzues i rrezikut, tolerant, apo pranues i rrezikut? A ka siguruesi plan strategjik? Qëllimi apo visioni i siguruesit? Si u komunikohen policmbajtësve dhe të punësuarëve ndryshimet në politika? Si shihet siguruesi nga konkurrentët – lider, inovator, përcjellëse, etj.

Produktet e siguruesit, shërbimet dhe tregjet – përfshinë përshkrimin e produkteve dhe shërbimet kryesore të siguruesit, duke veqar produktet e reja që nga ekzaminimi i fundit. A

janë produktet dhe shërbimet e zhvilluara dhe krijuara drejtpërdrejtë nga siguresi apo nga ndonjë person i jashtëm? Paraqiten funksionet apo shërbimet që siguresi mund t'i ketë të deleguara, si dhe aprovimet paraprake nga BQK për delegim të funksioneve respektive.

Shtojca II – 2. Mostra (shembull) mbi profilin e rrezikut të siguresit (profili i rrezikut)

<ul style="list-style-type: none"> - Emri i siguresit - Adresa: Rruga "xxxx", nr ... Prishtinë - Personi kontaktues i siguresit - Kryeshefi ekzekutiv: Xxxx Xxxx - Data fillestare e përgatitjes së profilit të rrezikut të siguresit: dita-muaji-viti 	<p>Informatat financiare (me date-dita-muaji-viti)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjithsej asetet xxx milion euro - Gjithsej bruto primet e shkruara xxx milion euro - Gjithsej neto primet e fituara xxx milion euro - Fitimi neto - ROAA xx% - ROAE xx% - Provizionet teknike - Rezervat për dëmet - RBNS - Rezerva për dëmet - IBNR - Tregues të tjerë financiar të rëndësishëm;
<ul style="list-style-type: none"> - <u>Lloji i ekzaminimit të fundit në vend</u> Ekzaminimi i plotë/Ekzaminimi i fokusuar - <u>Data e fillimit të ekzaminimit</u> Dita-muaji-viti - <u>Data e përfundimit të ekzaminimit</u> dita-muaji-viti - <u>Informatat financiare të datës</u> dita-muaji-viti 	<p><u>Ekzaminer Përgjegjës</u></p>

Vlerësimi i përgjithshëm i siguresit sipas metodologjisë "CARMELS"

Përshkrimi	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak (t-1)	Ekzaminimi paraprak (t-2)
Data e fillimit të ekzaminimit	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti
Ekzaminimi me të dhëna financiare deri më	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti
Vlerësimi i përgjithshëm	X	X	X
Vlerësimi i komponentëve:	X	X	X
Kapitali	X	X	X
Kualiteti i aseteve	X	X	X
Risigurimi	X	X	X
Kalkulimet aktuariale dhe provizionet teknike	X	X	X
Menaxhmenti	X	X	X
Fitimet			
Likuiditeti	X	X	X
Ndjeshmëria ndaj tregut			

3.2. Faza e dytë - vlerësimi i rrezikut

Procesi i vlerësimit të rrezikut duhet të ndërmerret para se të bëhet ndonjë ekzaminim në vend. Korniza vijuese e ekzaminimit të bazuar në rrezik duhet të përdoret për të gjithë siguruesit në Kosovë. Kjo është një kornizë e mbikëqyrjes që është në evoluim që në vazhdimësi azhuron vlerësimin e rrezikut për secilën sigurues.

Vlerësimi i rrezikut kryhet gjatë ciklit të mbikëqyrjes dhe kërkohet input nga personeli i ekzaminimit në vend dhe stafi i divizionit të raportimit dhe analizave (off-site). Ky proces duhet të kryhet së paku një herë në gjashtë muaj.

Vendimi për të kryer një ekzaminim me fushëveprim të plotë apo ekzaminim të fokusuar mund të merret vetëm pasi të kompletohet vlerësimi i rrezikut.

Vlerësimi i rrezikut gjithashtu mund të bëhet për të gjithë aplikantët që mund të aplikojnë për licencë si sigurues gjatë procesit të regjistrimit, duke u bazuar në informatat e ofruara si mbështetje për aplikacionin.

3.2.1 Korniza e vlerësimit të rrezikut - përmbledhje

Korniza e vlerësimit të rrezikut do të rezultojë me kategorizimin e përgjithshëm të rrezikut në: rrezik të ulët, moderuar, mbi mesatare ose të lartë.

Renditja e përbërë e rrezikut të siguruesit përcaktohet nga:

- Identifikimi i aktiviteteve të rëndësishme;
- Vlerësimi i rrezikut të qenësishëm për secilin aktivitet të rëndësishëm;
- Nxjerrja e rrezikut neto për secilin aktivitet të rëndësishëm duke vlerësuar shtrirjen deri ku rreziqet e qenësishme të identifikuar zbuten nga menaxhimi kualitativ i rrezikut;
- Kombinimi i rrezikut individual neto për të arritur deri te rreziku i përgjithshëm neto i siguruesit; dhe
- Rregullimi i rrezikut të përgjithshëm neto duke marrë parasysh kapitalin në dispozicion dhe fitimet për të përcaktuar renditjen e rrezikut të përbërë të siguruesit.

Drejtimi i rrezikut neto gjithashtu përcaktohet nga cilido aktivitet i rëndësishëm dhe ndryshimet e përgjithshme në biznesin e siguruesit. Vlerësimi i rrezikut dokumentohet duke përdorur matricën e rrezikut të mbështetur në përmbledhjen e vlerësimit të rrezikut dhe dokumentet e ndryshme mbështetëse të cilat detajohen në pjesët e mëvonshme.

Gjatë kryerjes së vlerësimit të rrezikut merret parasysh në veçanti vlerësimi i kualitetit të menaxhimit të rrezikut, natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të biznesit të siguruesit. Përveç vlerësimit të njohurive për vetë siguruesin, krahasimi mund të bëhet gjithashtu me siguruesit tjerë.

3.2.2 Qëllimi i kornizës

Qëllimi i kësaj kornize është ofrimi i procesit efektiv të vlerësimit të gjendjes aktuale të siguresve duke vlerësuar profilin e rrezikut të siguresve, proceset dhe praktikatat e tyre të menaxhimit të rrezikut, pozitën e tyre financiare dhe respektimin e legjislacionit.

3.2.3 Elementet e kornizës

Elementet kryesore të kornizës janë:

- Është e fokusuar në rrezik;
- Mbështetet në funksionet e kontrollit të menaxhmentit për mbikëqyrje të rrezikut, përfshirë punën e auditimit të brendshëm;
- Mbështetet në punën e bërë nga palët e treta siç janë auditorët e jashtëm dhe aktuarët;
- Ofron renditje rregullative të rrezikut për secilin sigures, bazuar në vlerësimin e rreziqeve të qenësishme të aktiviteteve të rëndësishme të një siguresi dhe kualitetin e funksionit të kontrollit të menaxhmentit për mbikëqyrje të rrezikut;
- Ofron komunikimin e gjetjeve dhe kërkesave për siguresit në një mënyrë konfidenciale, të qartë dhe me kohë;
- Siguron që niveli dhe frekuenca e shqyrtimit mbikëqyrës do të varet nga renditja e rrezikut; siguresit e menaxhuar mirë do të kenë nevojë për më pak mbikëqyrje;
- Promovon veprime të përshtatshme rregullative në linjë me profilin e rrezikut për një sigures; dhe
- Lehtëson zhvillimin e pikave krahasuese të cilat do të mundësojnë krijimin e praktikave më të mira të industrisë për t'u ballafaquar me nivele të ndryshme të rrezikut.

3.3. Procesi i vlerësimit të rrezikut – përmbledhje

Rreziku është mundësia e ndodhjes ose shkaktimit të dëmit, lëndimi, detyrimi, humbje apo ndonjë ngjarje tjetër negative, e shkaktuar nga ndryshueshmëria e faktorëve të jashtëm ose të brendshëm të cilat mund të neutralizohen përmes veprimeve të paramenduara.

Rreziku i qenësishëm i referohet mundësisë së humbjes që rrjedh nga rrethanat e caktuara në një ambient. Ambienti definohet si rrethanë, ndikim nga faktorët konkurrues, kulturor, demografik, ekonomik, natyror, politik, rregullativ dhe teknologjik që ndikojnë në mbarëvajtjen e operacioneve dhe rritjen e siguresit.

Vlerësimi i rrezikut dhe analizat e tij përbëhen nga:

- Identifikimi i kushteve, ngjarjeve dhe situatave të mundshme negative të jashtme dhe të brendshme;
- Përcaktimi i marrëdhënies të shkakut dhe efektit në mes të ngjarjeve të mundshme, madhësinë e tyre dhe rezultatet e mundshme;
- Vlerësimi i rezultateve të ndryshme sipas vlerësimeve dhe probabiliteteve të mundshme të ndodhjes së tyre;

- Aplikimi i teknikave kualitative dhe kuantitative për të zvogëluar paqartësinë e një rezultati dhe koston, detyrimin apo humbjen e ndërlidhur.


Ky vlerësim është i ilustruar nga raporti në vijim.

Rreziqet e qenësishme mund të zbuten përmes Kualitetit të Menaxhimit të Rrezikut = Rreziku Neto

Vlerësimi i rrezikut në kornizën tonë fillon me identifikimin e aktiviteteve të rëndësishme të një siguruesi. Rreziku neto i këtyre aktiviteteve të rëndësishme është funksion i rrezikut agregat të qenësishëm, i eliminuar nga kualiteti i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut.

Përmes tabelës 1 janë përcaktuar hapat të cilat duhet ndërmarr gjatë vlerësimit të rrezikut të siguruesit.

Tabela 1. Hapat që duhet ndërmarrë gjatë vlerësimit të rrezikut



Burimi: BQK (2019)

3.3.1 Hapi 1: Kuptimi i aktiviteteve të rëndësishme të siguruesit

Për të zhvilluar komponentët e rëndësishëm të ndërlidhur me rrezikun, identifikimi i aktiviteteve të rëndësishme të siguruesve konsiderohet si hapi i parë në krijimin e kornizës.

Aktivitetet e rëndësishme mund të përfshijnë çfarëdo linje të rëndësishme të biznesit, njësi apo proces. Ato identifikohen nga burimet e ndryshme përfshirë strukturën organizative të siguruesit, planet strategjike biznesore, performancën financiare dhe raportimin e brendshëm dhe të jashtëm financiar. Sipas gjykimit përcaktohet rëndësia apo materialiteti i çfarëdo aktiviteti në të cilin është i përfshirë siguruesi.

Në vijim janë dhënë shembujë të kriterëve kuantitative dhe kualitative që mund të përdoren për të përcaktuar materialitetin e një aktiviteti:

- Asetet e krijuara nga aktiviteti në raport me asetet totale;
- Të hyrat e krijuara nga aktiviteti në raport me të hyrat e përgjithshme;
- Të ardhurat neto para tatimit për aktivitetin në raport me gjithësej të ardhurat neto para tatimit;
- Ekspozimi i marrjes në sigurim në raport me kapitalin;
- Rezervat e mbajtura si përqindje e gjithsej rezervave;
- Kategoria e asetëve të çvlerësuara në raport me gjithsej asetet;
- Rëndësia strategjike;
- Ndikimi në reputacion; dhe
- Proceset kyçe të shtrira në tërë ndërmarrjen.

3.3.2 Hapi 2: Kuptimi i rreziqeve të qenësishme të siguruesit

Rreziku i qenësishëm është i pandashëm nga një aktivitet biznesor dhe rrjedh nga ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet potenciale të ardhshme. Rreziku i qenësishëm vlerësohet duke konsideruar shkallën e probabilitetit dhe ndikimin e mundshëm negativ në kapitalin apo fitimet e siguruesit. Një kuptim i plotë i ambientit ku një sigurues operon dhe aktivitetet e ndryshme biznesore të tij janë esenciale për të identifikuar në mënyrë efektive dhe për të vlerësuar rrezikun e qenësishëm në ato aktivitete.

Për kornizën tonë do të përdorim definicionet vijuese të rrezikut të qenësishëm:

Probabiliteti i humbjes që rrjedh nga rrethanat në një ambient. Ambienti është i definuar si rrethanë, ndikim dhe faktorët konkurrues, kulturor, demografik, ekonomik, natyror, politik, rregullativ dhe teknologjik që ndikojnë në mbijetimin e operacioneve dhe rritjen e një siguruesi.

Rreziqet e qenësishme janë paraqitur në kategoritë vijuese për qëllim të vlerësimit të rrezikut.

1) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor rrjedh nga paaftësia ose mosgatishmëria e palës tjetër për të përmbushur obligimet kontraktuale që gjenden në bilanc të gjendjes dhe jashtë bilancit të gjendjes. Ekspozimi ndaj këtij rreziku rezulton nga transaksionet financiare me një palë e cila mund të jetë sigurues, debitor, huamarrës, broker, policëmbajtës, risigurues ose garantues.

2) Rreziku i investimeve ose i tregut

Rreziku i tregut rrjedh nga ndryshimet në normat ose çmimet e tregut. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të rezultojë nga marrja e pozicionit të caktuar në treg dhe aktivitetet e ndërlidhura me marrjen e pozicionit siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, ekuiteti, mallrat dhe patundshmëritë. Rreziku i normës së interesit dhe rreziku i kursit të këmbimit janë të

përshkruar si: rreziku i normës së interesit që rrjedh nga lëvizjet në normat e interesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku në rend të parë rezulton nga dallimet kohore në rivlerësimin e asetëve dhe detyrimeve, edhe të atyre që janë në bilance të gjendjes dhe atyre që janë jashtë tij, qoftë për shkak se maturojnë (instrumente me normë fikse) apo rivlerësohen sipas kontratës (instrumente me normë lëvizëse). Rreziku i kursit të këmbimit valutor rrjedh nga lëvizjet në kursin e këmbimit valutor. Ekspozimi ndaj këtij rreziku zakonisht ndodhë gjatë një periudhe në të cilën siguruesi ka një pozitë të hapur, brenda dhe jashtë bilancit të gjendjes, dhe/ose është i përfshirë në tregjet spot dhe forward.

3) Rreziku sigurues

Ekzistojnë dy fusha kryesore të rrezikut sigurues, përfshirë produktet dhe marrjen e rreziqeve në sigurim. Rreziku i dizajnit të produktit dhe vendosja e çmimit dalin nga ekspozimi drejt humbjes financiare nga transaksionet e biznesit të sigurimeve ku kostoja dhe detyrimet e marra në lidhje me linjën e produkteve, tejkalojnë pritjet nga vendosja e çmimit për atë produkt.

Rreziku i marrjes në sigurim dhe detyrimeve është ekspozimi ndaj humbjeve financiare që rezulton nga përzgjedhja dhe aprovimi i rreziqeve që do të sigurohen, zbritja, mbajtja dhe transferimi i rrezikut, rezervimi, trajtimi dhe rregullimi i dëmeve, si dhe menaxhimi i produkteve të kontraktuara.

4) Rreziku operacional

Rreziku operacional rrjedh nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të rezultojë nga mangësitë apo prishjet e kontrolleve apo proceset e brendshme, dështimeve teknologjike, gabimeve njerëzore dhe katastrofave natyrore.

5) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga mos-aftësia e siguruesit që të ketë fondet e domosdoshme në dispozicion, qoftë përmes rritjes së detyrimeve ose mbulimit të asetëve, për të plotësuar obligimet e tij në bilanc të gjendjes dhe jashtë tij kur të vijë koha e pagesës së tyre, pa pësuar humbje të papranueshme.

6) Rreziku ligjor dhe rregullativ

Rreziku ligjor dhe rregullativ rrjedh nga pamundësia e respektimit, nga ana e siguruesit ose pala e ndërlidhur, të legjislacionit dhe përfshinë rrezikun e reputacionit.

7) Rreziku strategjik

Rreziku strategjik rrjedh nga paaftësia e siguruesit për të implementuar planin adekuat të biznesit.

3.3.3 Hapi 3: Identifikimi i niveleve të rrezikut të qenësishëm në secilën prej aktiviteteve të rëndësishme

Pasi që të identifikohen aktivitetet e rëndësishme, bëhet vlerësimi i nivelit për secilin rrezik të qenësishëm për ato aktivitete si i ulët (U), i mesëm (M), mbi mesatare (MM) ose i lartë (L).

Rreziku i ulët i qenësishëm (U):

Rreziku i ulët i qenësishëm ekziston atëherë kur ekziston probabiliteti më i ulët se mesatarja që të ketë një ndikim të pafavorshëm mbi kapitalin apo fitimet e siguresit për shkak të ekspozimit dhe pasigurisë nga ngjarjet e ardhshme potenciale.

Rreziku mesatar i qenësishëm (M):

Rreziku i qenësishëm mesatar ekziston kur ka një probabilitet mesatar të ndikimit të pafavorshëm mbi kapitalin ose fitimet e siguresit për shkak të ekspozimit dhe pasigurisë nga ngjarjet e ardhshme potenciale.

Rreziku mbi mesataren i qenësishëm (MM):

Rreziku i qenësishëm mbi mesataren ekziston kur ka një probabilitet mbi mesatar të ndikimit të pafavorshëm mbi kapitalin ose fitimet e siguresit për shkak të ekspozimit dhe pasigurisë nga ngjarjet e ardhshme potenciale.

Rreziku i lartë i qenësishëm (L):

Rreziku i qenësishëm i lartë ekziston kur ka një probabilitet të lartë të ndikimit të pafavorshëm mbi kapitalin ose fitimet e siguresit për shkak të ekspozimit dhe pasigurisë nga ngjarjet e ardhshme potenciale. Ky vlerësim bëhet pa marrë në konsiderim ndikimin e zbutjes së rrezikut përmes proceseve dhe kontrolleve të menaxhimit të rrezikut të siguresit.

3.3.4 Hapi 4: Përcaktimi i kualitetit të menaxhimit të rrezikut të siguresi

Kualiteti i menaxhimit të rrezikut vlerësohet për secilin aktivitet të rëndësishëm. Përveç menaxhimit operacional (menaxhimit të përditshëm), korniza identifikon funksione të mundshme të kontrolleve për menaxhimin e rrezikut (funksione të pavarura mbikëqyrëse) të një siguresi.

Funksionet e mundshme të kontrollit për menaxhimin e rrezikut

Këto mund të përmbliidhen sipas titujve vijues si shembull për tu përcjell nga personeli i ekzaminimit:

Analizat financiare

Analizat financiare janë analiza të thella të rezultateve operacionale për një sigures dhe i raportohen menaxhmentit ekzekutiv. Raportimi efektiv është kyç për këtë funksion, pasi që rezultatet operacionale ndikojnë mbi vendimet strategjike dhe biznesore të marra nga menaxhmenti dhe bordi.

Menaxhimi operacional

Menaxhimi operacional është planifikimi, drejtimi dhe kontrollimi i operacioneve të përditshme të aktiviteteve biznesore të një siguruesi.

Pajtueshmëria

Pajtueshmëria është një funksion brenda një siguruesi që:

- Cakton politikat dhe procedurat për respektimin e kërkesave rregullative; dhe
- Monitoron përmbushjen nga ana e siguruesit të këtyre politikave dhe procedurave; dhe raporton mbi çështjet e përmbushjes te menaxhmenti ekzekutiv dhe bordi.

Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm është një funksion i pavarur brenda një siguruesi që vlerëson respektimin dhe efikasitetin e kontrolleve operacionale dhe organizative. Përveç kësaj, auditimi i brendshëm mund të vlerësoj edhe respektimin dhe efikasitetin e politikave dhe procedurave të përmbushjes dhe menaxhimit të rrezikut.

Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi i rrezikut është një funksion i pavarur përgjegjës për planifikimin, drejtimin dhe kontrollimin e ndikimit të rreziqeve që mund të rezultojnë nga operacionet e siguruesit. Ky funksion mund të adresoj çështjet vijuese: identifikimin e rrezikut, zhvillimin e sistemit matës për rrezik, krijimin e politikave dhe procedurave për të menaxhuar rrezikun, zhvillimin e limiteve të tolerimit të rrezikut, monitorimi i pozitive kundrejt limiteve të aprovuara për tolerimin e rrezikut, si dhe raportimin e rezultateve të monitorimit të rrezikut te menaxhmenti ekzekutiv dhe bordi.

Menaxhmenti Ekzekutiv

Menaxhment ekzekutiv janë menaxhmenti i lartë brenda siguruesit që është përgjegjës për planifikim, drejtim dhe kontrollim të drejtimit strategjik dhe operacioneve të përgjithshme të siguruesit. Përgjegjësitë e tyre kryesore përfshijnë:

- Sigurimi se kontrollet organizative dhe procedurale janë efektive;
- Sigurimi se politikat dhe procedurat e aprovuara janë duke u përmbushur;
- Zhvillimi i strategjive dhe planeve për të arritur qëllimet e aprovuara strategjike dhe biznesore; dhe
- Zhvillimi i praktikave, kulturës dhe etikës së shëndoshë biznesore.

Mbikëqyrja nga bordi

Bordi i drejtorëve merr përsipër përgjegjësinë përfundimtare për funksionet e kontrollit të menaxhimit të rrezikut. Implementimi i këtyre funksioneve zakonisht i delegohet ekzekutivit menaxhues, të cilët pastaj mund t'ia delegojnë tutje këto funksione specialistëve. Bordi i drejtorëve është përgjegjës për ofrimin e mbikëqyrjes mirëbesuese dhe menaxhuese për siguruesin. Përgjegjësitë kryesore të tij përfshijnë: sigurimi se menaxhmenti është i kualifikuar dhe kompetent, shqyrtimi dhe aprovimi i kontrolleve organizative dhe procedurale, sigurimi se rreziqet kryesore të identifikohen dhe menaxhohen si duhet, shqyrtimi dhe aprovimi i politikave dhe procedurave për aktivitetet kryesore të siguruesit, shqyrtimi dhe aprovimi i

planeve strategjike dhe biznesore, si dhe ofrimi i vlerësimit të pavarur për kontrollet e menaxhmentit.

Konsiderimet shitesë për funksionet e kontrollit

Aty ku siguresve i'u mungon një pjesë ose të gjitha funksionet e pavarura të kontrollit të menaxhimit të rrezikut të referuara më lartë, fokusimi do të vendoset mbi funksionet tjera të tyre, të brendshme ose të jashtme, që menaxhojnë këto përgjegjësi. Në përgjithësi, nëse një sigures nuk ka një funksion të pavarur të kontrollit të menaxhimit të rrezikut (për shembull, analizat financiare) performanca e funksionit të menaxhimit të rrezikut mbetet pjesë e funksionit të menaxhmentit ekzekutiv, ndërsa menaxhmenti ekzekutiv do të vlerësohet nëse janë duke e plotësuar si duhet këtë funksion.

Prezenca dhe natyra e këtyre funksioneve dallon varësisht nga natyra, madhësia dhe kompleksiteti i siguresit. Për shembull te siguresit më të vegjël, mund të mos jetë e arsyeshme që t'i kenë të gjitha funksionet e kontrollit të menaxhimit të rrezikut të kryera në baza të vetme të pavarura, në të cilin rast siç edhe u cek më lartë, kontrollet e tilla mbesin pjesë e përgjegjësi të menaxhmentit ekzekutiv i cili do të vlerësohet për këtë. Te siguresit e vegjël, ndonjëherë ndodhë që menaxhmenti ekzekutiv kryen funksionet e menaxhimit operacional. Në këto raste është sfidë për siguresit që të demonstrojnë se kanë mekanizma të vendosur për të siguruar mbikëqyrje të përshtatshme të pavarur për këto funksione të menaxhimit operacional.

3.3.5 Hapi 5: Vlerësimi i kualitetit të funksioneve të kontrollit te siguresi

Për secilin aktivitet të rëndësishëm, vlerësohet kualiteti i funksioneve të kontrollit të menaxhimit të rrezikut aktual të siguresit. Kualiteti i menaxhimit të rrezikut vlerësohet si i dobët (D), ka nevojë për përmirësim (NP), e pranueshme (P), ose e fortë (F).

Tabela 2. Udhëzues i vlerësimit të menaxhimit të rrezikut

Dobët (D)	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron raste serioze ku duhet të përmirësohet efektshmëria përmes veprimeve të menjëhershme; karakteristikat dhe performanca në përgjithësi nuk plotësojnë praktikën dhe standardet e pranuar në industri.
Ka nevojë për përmirësim (NP)	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron performancë efektive, por mund të jenë disa fusha ku efektshmëria mund të përmirësohet (por jo aq serioze sa të shkaktoj shqetësime të qëndrueshmërisë financiare).
E pranueshme (P):	<ul style="list-style-type: none"> • Domonstron performancë efektive dhe plotëson praktikën dhe standardet e pranuar në përgjithësi të industrisë.
E fortë (F):	<ul style="list-style-type: none"> • Në mënyrë të vazhdueshme demonstroi performancë të lartë efektive. Karakteristikat dhe performanca janë superiore ndaj praktikave të pranuar në përgjithësi të industrisë.

Burimi: BQK (2019)

3.3.6 Hapi 6: Vlerësimi i rrezikut neto të siguruesit

Rreziku neto për secilin aktivitet të rëndësishëm është një funksion i nivelit agregat të rrezikut të qenësishëm të balancuar përmes kualitetit të menaxhimit të rrezikut. Për shembull, rreziku neto i një aktiviteti të rëndësishëm me rrezik të qenësishëm mbi mesatare mund të vlerësohet si i moderuar për shkak të zbutjes përmes kualitetit të fortë agregat të menaxhimit të rrezikut që rezulton nga menaxhimi i fortë operacional, auditimi i fortë i brendshëm, menaxhimi i fortë i rrezikut, si dhe mbikëqyrjes së fortë nga bordi.

Vlerësimi i rrezikut gjithashtu përfshinë përcaktimin e drejtimit aktual të rrezikut neto. Drejtimi i rrezikut vlerësohet si: në rënie (R), stabil (S), ose në ngritje (N). Ky vlerësim bëhet përgjatë një periudhe të përshtatshme kohore për një sigurues, duke u bazuar në rrethanat e atij siguruesi dhe këndvështrimit të vlerësimit nga vlerësuesi.

3.3.7 Hapi 7: Zhvillimi i matricës së rrezikut për një sigurues

Pasi që të kompletohet vlerësimi i rrezikut, vlerësimi regjistrohet në matricën e rrezikut (referojuni shtojcës 1).

Si përmbledhje, matrica e rrezikut është për të përcaktuar:

- Vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut neto;
- Vlerësimin e përgjithshëm të kualitetit të secilit funksion të kontrollit për menaxhimin e rrezikut;

- Vlerësimin e përbërë të rrezikut;
- Drejtimin e vlerësimit të përbërë të rrezikut; dhe
- Intervalin kohor para të cilit duhet të bëhet shqyrtimi i vlerësimit.

Në arritjen deri te vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut neto, merret në konsiderim rëndësia relative ose materialiteti për secilin aktivitet. Rreziku i përgjithshëm neto vlerësohet si i ultë (U), mesatar (M), mbi mesatar (MM) ose i lartë (L). Ky vlerësim siguron që një aktivitet me materialitet të ulët por rrezik të lartë neto nuk do të deformojë vlerësimin e përbërë të rrezikut. Përpjekjet mbikëqyrëse do të fokusohen në rend të parë në aktivitetet e rëndësishme materiale me rrezik të lartë. Sidoqoftë, aktivitetet tjera gjithashtu do të shqyrtohen për shkak të ndikimit që mund të kenë ato mbi vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut për siguruesin.

Vlerësimi i përbërë i rrezikut përfshin shqyrtimin e kapitalit dhe fitimeve të siguruesit, duke marrë parasysh kualitetin, kuantitetin dhe disponueshmërinë e kapitalit dhe fondeve të jashtme të krijuara brenda siguruesit. Një periudhë e përshtatshme kohore për shqyrtimin dhe azhurnimin e vlerësimit të përbërë të rrezikut dhe drejtimin të tij gjithashtu përfshihet.

Matrica e rrezikut duhet të mbështetet nga analizat e dokumentuara dhe përfundimet racionale, para se të komunikohen gjetjet apo rekomandimet te siguruesi.

Kërkohet nga menaxhmenti i Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve që të shqyrtojë vlerësimet përfundimtare. Vlerësimet e kompletuara të rrezikut do të shpalosen dhe do të diskutohen me siguruesit individual në baza konfidenciale.

3.3.8 Veprimet potenciale përcjellëse

Varësisht nga vlerësimi i rrezikut të përbërë të siguruesit, mund të ketë nevojë për intervenim mbikëqyrës. Intervenimi është pjesë e rëndësishme e procesit të ekzaminimit në vend (on-site). Konsiderohet relevante që të bëhet përmbledhja e veprimeve potenciale intervenuese duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe kornizën rregulltive mbikëqyrëse.

Paragrafët vijues detajojnë intervenimet të cilat mund t'i konsideroj BQK-ja varësisht nga vlerësimi i përbërë i rrezikut për secilin sigurues.

Procesi i intervenimit nuk është ndonjë masë e përcaktuar dhe nuk mundet secila situatë të adresohet me një grumbull të paracaktuar të veprimeve. Rrethanat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga rasti në rast dhe fushëveprimi i intervenimit nuk duhet të interpretohet si kufizues i fushëveprimit të BQK-së në adresimin e problemeve apo kompanive specifike. Udhëzuesi i intervenimit ka për qëllim të tregoj se në cilin nivel do të ndodhte zakonisht një veprim/intervenim. Sidoqoftë, intervenimet e përshkruara në një nivel mund të përdoren në një nivel të mëvonshëm, në ndonjë situatë; disa intervenime mund të ndodhin në nivele të mëhershme nga ajo që është e përcaktuar në udhëzues.

Përveç kësaj, BQK-ja mund të zgjedh të implementoj fuqitë e saj në kohëra të ndryshme dhe/ose të përcaktoj veprimet tjera.

3.4. Kategoritë e vlerësimit të rrezikut të përbërë

Kategoritë vijuese të vlerësimit mund të përdoren si udhëzues për veprimet e mundshme intervenuese.

Ulët deri mesatar: (nuk ka probleme të rëndësishme, aktivitetet normale)

Nëse BQK përcakton se gjendja financiare e një siguruesi, politikat dhe procedurat janë të mjaftueshme dhe se praktikat, kushtet dhe rrethanat nuk tregojnë për ndonjë problem të rëndësishëm apo mungesë të kontroleve, atëherë siguruesi zakonisht merr një vlerësim të rrezikut të përbërë të ulët apo mesatar. Kombinimi i rrezikut të përgjithshëm neto të siguruesit, kapitali dhe fitimet e bëjnë siguruesin të qëndroj ndaj shumicës së kushteve normale të pafavorshme biznesore dhe ekonomike. Performanca e siguruesit ka qenë e kënaqshme deri të mirë. Siguruesi mund të ketë qasje në kapital shtesë dhe është në gjendje të adresoj shqetësimet e mundshme të mbikëqyrësit.

Në këtë situatë aktivitetet dhe përgjegjësitë e BQK-së mund të përfshijnë:

- Vlerësimin e gjendjes financiare dhe performancës operative të siguruesit;
- Shqyrtimi i informatave të marra nga raportet tremujore dhe vjetore;
- Mbajtja e takimeve me siguruesin;
- Kryerja e shqyrtimeve të rregullta mbikëqyrëse për siguruesin të bazuar në rrezik;
- Ofrimi i letrës së menaxhmetit për siguruesin pas secilës vizite në vend, ku do të këshillohet siguruesi për çfarëdo mase korrektuese që mund të kërkohet nga ta; dhe
- Monitorimi i masave korrektuese, ku mund të përfshihen kërkesa për informata shtesë dhe/ose kryerja e shqyrtimeve përcjellëse mbikëqyrëse.

Mesatar deri mbi mesatar: (mangësi ose shqetësime rreth gjendjes financiare, paralajmërim i hershëm)

Nëse BQK ka identifikuar mangësi apo shqetësime rreth gjendjes financiare të siguruesit, politikat apo procedurat e tij, ekzistimin e praktikave, kushteve dhe rrethanave tjera të cilat mund të shpijnë drejt krijimit të problemeve, atëherë siguruesi zakonisht do të pranojë vlerësim mesatar deri mbi mesatar të rrezikut nëse mangësitë ose shqetësimet nuk adresohen menjëherë.

Kombinimi i rrezikut të përgjithshëm neto të siguruesit dhe kapitalit e fitimeve të tij përbëjnë qëndrueshmërinë e siguruesit. Siguruesi gjithashtu mund të ketë probleme me menaxhimin e rrezikut ose mangësitë në kontrole, edhe pse jo aq serioze që do të përkeqësonin situatën në ndonjë problem më serioz nëse nuk adresohet.

Në këtë situatë aktivitetet dhe përgjegjësitë e BQK-së mund të përfshijnë:

- Njoftimi zyrtar i menaxhmentit, bordit të drejtorëve, aktuarit statutor dhe auditorit të jashtëm të siguruesit përmes letrës për menaxhmentin ku kërkohet nga siguruesi që të ndërmer masa për të zbutur apo përmirësuar mangësitë e identifikuara.
- Takimi me menaxhmentin, bordin e drejtorëve (apo ndonjë komision të bordit), aktuarin dhe/ose auditorin e jashtëm të siguruesit për të bërë një përmbledhje të shqetësimeve të evidentuara dhe për të diskutuar veprimet përmirësuese.
- Monitorimi i siguruesit në baza eskaluese duke rritur frekuencën e kërkesave raportuese dhe/ose zgjerimin e nivelit të detajeve të informatave të cilat kërkohen që të dorëzohen nga siguruesi.
- Kryerja e shqyrtimeve të zgjeruara ose më të shpeshta që fokusohen në ndonjë fushë të caktuar ku ka shqetësime siç janë vlerësimi i aseteve ose vlerësimet e detyrimeve ndaj policave, të cilat mund të përfshijnë caktimin e ndonjë personi të pavarur për të kryer këtë.
- Kërkesa ndaj siguruesit që të rrisë kapitalin e tij.
- Imponimi i kushteve mbi siguruesin në rrethanat e caktuara dhe/ose lëshimi i direktivës për përmbushje në rrethanat e caktuara.

Mbi mesatare deri në i lartë: (rrezik për qëndrueshmërinë financiare ose solvencën)

Vlerësimi i rrezikut të përbërë mbi mesatare deri te i lartë do të thotë se BQK-ja mendon se ka shqetësime për sigurinë dhe shëndetin material të siguruesit dhe se është i ndjeshëm ndaj kushteve të pafavorshme biznesore dhe ekonomike.

Problemet janë identifikuar që mund të përkeqësohen në ndonjë situatë serioze nëse nuk adresohet menjëherë, edhe pse problemet nuk janë aq serioze për të kërcënuar menjëherë qëndrueshmërinë financiare ose solvencën. Kombinimi i rrezikut të përgjithshëm neto të siguruesit, kapitali dhe fitimet e bëjnë të ndjeshëm ndaj kushteve të pafavorshme biznesore dhe ekonomike, gjë e cila mund të jetë kërcënim serioz për qëndrueshmërinë financiare apo solvencën në rast se nuk ndërmerren veprime efektive korrektuese. Siguruesi gjithashtu mund të ketë probleme me menaxhmentin, edhe pse jo aq serioze për të kërcënuar menjëherë qëndrueshmërinë financiare ose solvencën, mund të përkeqësohet në probleme më serioze nëse nuk adresohen menjëherë.

Në këtë situatë aktivitetet dhe përgjegjësitë e BQK-së mund të përfshijnë:

- Monitorimi i zgjeruar përmes monitorimit të masave përmirësuese duke imponuar kërkesa të raportimit më të shpeshtë;
- Kryerja e shqyrtimeve përcjellëse mbikëqyrëse më shpesh dhe/ose zgjerimi i fushëveprimit të tyre;

- Kërkesa që siguruesi të dorëzoj një plan të biznesit i cili përfshinë masat e duhura përmirësuese që kanë për qëllim zgjedhjen e problemeve brenda një kornize të caktuar kohore;
- Kërkesa që auditori i jashtëm i siguruesit të zgjerojë fushëveprimin e shqyrtimit të pasqyrave financiare;
- Kërkesa që siguruesi të kryej një auditim special që do të kryhet nga një auditor tjetër nga auditori i jashtëm i siguruesit;
- Kërkesa që aktuari të ofroj detyrimet e policave të kalkuluara duke përdorur vlerësime apo metoda alternative; dhe
- Kërkesa që një aktuarë i jashtëm të kryej një shqyrtim special të rezervave aktuariale të siguruesit

I lartë (qëndrueshmëria financiare në të ardhmen është vënë në dyshim serioz)

Kjo fazë përshkruan situatën ku një sigurues kategorizohet se i takon vlerësimit të rrezikut të lartë të përbërë dhe BQK-ja ka identifikuar se siguruesi ka dështuar që të zgjedh problemet që janë identifikuar dhe se situata është duke u përkeqësuar. Për siguruesin ka shqetësime serioze sa i përket sigurisë dhe është duke u ballafaquar me probleme që paraqesin kërcënim material për qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen ose solvencën nëse nuk ndërmerren masa korrektuese menjëherë.

Kombinimi i rrezikut të përgjithshëm neto të siguruesit dhe kapitalit si dhe fitimeve e bën të ndjeshëm ndaj kushteve të pafavorshme biznesore dhe ekonomike, gjë e cila paraqet kërcënim serioz ndaj qëndrueshmërisë financiare dhe solvencës nëse nuk ndërmerren veprime efektive korrektuese menjëherë. Si alternativë siguruesi ka probleme serioze në menaxhimin e rrezikut ose mangësi në kontrole të brendshme, të cilat paraqesin rrezik serioz ndaj qëndrueshmërisë ose shëndetit financiar nëse nuk ndërmerren veprime korrektuese menjëherë.

Në këtë situatë aktivitetet dhe përgjegjësitë e BQK-së mund të përfshijnë:

- Angazhimi i specialistëve ose profesionistëve të jashtëm që të vlerësojnë fushat e caktuara siç mund të jenë kualiteti i aseteve, likuiditeti, mjaftueshmëria e rezervave, mjaftueshmëria për detyrimet ndaj policave, besueshmëria e marrëveshjeve për risigurim, etj.
- Zgjerimi i fushëveprimit të kushteve të regjistrimit të cilat tanimë i janë imponuar siguruesit;
- Zgjerimi i nivelit të detajeve për informatat të cilat kërkohet nga siguruesi që t'i dorëzoj në BQK.

I lartë me trend të rritjes (problemet me paqëndrueshmëri në solvencë të pashmangshme)

Kjo fazë i referohet rasteve ku BQK-ja ka përcaktuar se siguruesi është duke u përballur me vështirësi të rënda financiare dhe është përkeqësuar deri në atë masë sa që:

- siguruesi ka dështuar që të përmbushë kërkesat rregullative për kapital dhe suficit së bashku me paaftësinë që të përmirësojë situatën në bazë të menjëhershme;
- siguruesi ka dështuar në zhvillimin dhe implementimin e planit të biznesit, duke rezultuar në atë se rrethanat paraprijëse do të bëhen të pashmangshme brenda një periudhe të shkurtër kohore

Në këtë situatë aktivitetet dhe përgjegjësitë e BQK-së mund të përfshijnë:

- Lëshimi i njoftimit për siguruesin ku i bëhet me dije se BQK ka për qëllim që të ndalojë siguruesin nga bërja e biznesit të ri; dhe/ose
- Masat për fillimin e procesit të administrimit/likuidimit të siguruesit.

4. Faza e tretë - ekzaminimet në vend

4.1. Planifikimi dhe përgatitja

Korniza ligjore dhe rregullative i jep kompetencë të plotë BQK-së për të ekzaminuar siguruesit dhe risiguruesit, si dhe të mbledhë çfarëdo llojë të informatave.

Për më shumë, BQK-ja ka autoritet, aty ky është e përshtatshme, që të zgjeroj ekzaminimet e veta drejtë ndërmjetësuesve/brokerëve dhe kompanive tjera të kontraktuara nga jashtë për kryerjen e funksioneve të caktuara për siguruesit.

Pas analizave të informatave financiare dhe statistikore të dërguara nga siguruesit, (p.sh. pas procedurave të analizave/off-site) BQK-ja duhet të zhvilloj një plan, të bazuar në analiza sistematike të shënimeve të siguruesve, për ekzaminimet në vend të cilat duhet të bëhen gjatë muajve në vijim.

Faza e planifikimit përfshinë njohuritë nga profilet e rrezikut të siguruesve për të përcaktuar prioritetet e ekzaminimeve për secilin sigurues.

Pasi që të përcaktohet se cilët janë siguresit me nivelin më të lartë të rrezikut, atëherë mund të shqyrtohen fushat specifike brenda këtyre siguruesve të cilat paraqesin kërcënimin më të madh për qëndrueshmërinë financiare të atyre siguruesve (dhe/ose të gjithë tregut në tërësi).

Për shembull, nëse siguruesi në fjalë është mbështetur shumë në risigurime dhe pozita e tij financiare së fundi është përkeqësuar, duhet shikuar nga afër rregullimet e risigurimeve në mënyrë që të sigurohet, nëse është nevoja, se risiguruesi do të paguaj obligimet kur të ndodhë humbja.

Nëse ky sigurues i njëjtë ka histori të investimeve konservative të fondeve të veta dhe ka një nivel të ulët të rrezikut në këtë fushë, atëherë gjasat janë që nuk do ketë nevojë të madhe për ekzaminimin e pjesës së investimeve.

Strategjia është që të përdoren informatat në dispozicion për të përcaktuar prioritetet e ekzaminimit, edhe në kuptim të identifikimit të siguruesve individuale për t'u ekzaminuar fushat funksionale brenda tyre.

Plani final do të marr në konsiderim frekuencën e vizitave për ekzaminim në vend për secilin sigurues si dhe profilin e rrezikut për secilin sigurues. Ekzaminimet në vend janë më të shpeshta dhe më të thella kur në pyetje janë siguresit të cilët janë në pozitë të vështirë financiare. Sidoqoftë, një ndryshim kryesor në menaxhmentin e lartë apo në qëllimet dhe planin e biznesit të siguresit mund të jetë arsye e mjaftueshme për një ekzaminim të ri në vend.

Plani i ekzaminimit në vend duhet të jete fleksibil pasi që mund të shfaqen prioritetet e reja gjatë vitit. Përveç kësaj, kohëzgjatja e ekzaminimit është e parashikueshme dhe mund të zgjasë nga një ditë deri në disa javë varësisht nga lloji i ekzaminimit, madhësia e siguresit, problemet që mund të gjenden te siguruesi dhe çështjet tjera të rëndësishme për aktivitetin e siguresit.

Ekzaminimi në vend duhet të filloj me një përmbledhje të siguresit në mënyrë që të mund të bëhet planifikimi i duhur dhe vendoset fokusi në punën e terrenit. Ky shqyrtim duhet të ndiqet

së bashku me mbikëqyrësit e caktuar dhe të rezultojë me një plan të punës që duhet kryer në ekzaminimet në vend.

Ekzaminimet në vend sipas qasjes të ekzaminimit të bazuar në rrezik fokusohen në vlerësimin e llojeve dhe shtrirjes së rreziqeve ndaj të cilave janë të ekspozuar siguruesit.

Siguruesit kanë kontrole të brendshme të menaxhimit të cilat i përdorin për të monitoruar operacionet e përditshme të tyre. Një nga karakteristikat kryesore të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është fokusi i shtuar në vlerësimin e atyre kontroleve të menaxhimit e jo vetëm në vlerësimin e rezultateve të menaxhimit.

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik përveç se është një sistem për vlerësimin e rrezikut, përfshin veprime mbikëqyrëse që duhet të ndërmerren për nivele të caktuara të rrezikut, duke rritur masën e ndërhyrjes mbikëqyrëse sipas nivelit të rrezikut.

4.2. Llojet e ekzaminimeve

Ekzistojnë dy lloje të ekzaminimeve në vend:

- Ekzaminimet e plotë; dhe
- Ekzaminimet me fushëveprim të kufizuar (të fokusuara).

Para kompletimit të ekzaminimit në vend për secilin sigurues, duhet të kryhet një vlerësim i rrezikut për secilin sigurues në mënyrë që të përcaktohet nëse siguruesi do t'i nenshtrohet ekzaminimit të plotë apo me fushëveprim të kufizuar.

Ekzaminimi i plotë konsiderohet ekzaminim me një qëllim të përgjithshëm për të ofruar një raport të detajuar mbi pozitën financiare të siguruesit dhe çështjeve tjera që lidhen me aktivitetin e tij.

Ekzaminimi me fushëveprim të kufizuar, shpesh i quajtur si ekzaminim i fokusuar, kryhet për të shqyrtuar aspektet specifike të performancës apo situatës financiare të siguruesit dhe/ose fushat specifike të operacioneve të siguruesit.

4.2.1 Ekzaminimi i plotë

Nëse pas vlerësimit të rrezikut të një siguruesi, BQK-ja përcakton se një ekzaminim i plotë është i domosdoshëm, ekzaminimi duhet të mbulon fushat e rreziqeve, dhe do të fokusohet edhe në ekzaminimin dhe vlerësimin e fushave, si:

- Mjaftueshmërinë e kapitalit;
- Cilësinë e aseteve;
- Risigurimin;
- Mjafueshmërinë e provizioneve teknike;
- Menaxhmentin;

- Fitimet;
- Likuiditetin;
- Ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut;

Në mënyrë që të ekzaminohen çështjet e cikleve si më lartë, ekzaminimi do të përfshijë aktivitetet si në vijim që do të kryhen nga stafi i ekzaminimit:

- Një vlerësim të menaxhmentit, auditimit dhe sistemit të kontrolleve të brendshme;
- Një analizë të natyrës së aktiviteteve të siguruesit, p.sh. llojin e produkteve të sigurimit, llojin e policëmbajtësve dhe gjendjen e dëmeve;
- Një vlerësim i pozitës teknike të biznesit të sigurimit dhe/ose një vlerësim të organizatës dhe menaxhmentin e siguruesit, politikat dhe mbulesën e risigurimit dhe si ky mbulim ofron siguri për siguruesin dhe policëmbajtësit e tij;
- Një analizë të marrëdhënieve me entitetet e jashtme, siç mund të jetë përmes kontraktimit të jashtëm apo në lidhje me siguruesit tjerë të grupit të njëjtë;
- Një vlerësim i fuqisë financiare të siguruesit, me theks të vecantë të provizioneve teknike;
- Një vlerësim të respektimit të kërkesave për qeverisje korporative;
- Ekzaminimin dhe vlerësimin e teknologjisë informative;
- Ekzaminimin dhe vlerësimin e saktësisë së raportimit në pajtueshmëri me SNRF-të dhe kërkesat specifike të BQK-së;
- Kontrolli i mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë të informatave që i ofrohen policëmbajtësve;
- Shqyrtimi i kohës së pagesave;
- Shqyrtimi i frekuencës dhe natyrës të ndërmjetësimit ligjor; dhe
- Vlerësimi i respektimit të standardeve të sjelljes së mirë në treg dhe rregulloreve për korrektësinë ndaj policëmbajtësve.

Përveç kësaj, ekzaminimet efektive në vend mund të kenë nevojë që të përfshijnë qasjen të ofruesit e shërbimeve të kontraktuara apo palët tjera për të siguruar se BQK-ja kupton sa duhet nivelin e rrezikut të cilin e ka siguruesi dhe nivelin e mbrojtjes që e kanë policëmbajtësit kur siguruesi ka transferuar funksionet dhe informatat jashtë siguruesit.

Aty ku një autoritet tjetër rregullativ mbikëqyrë ofruesin e shërbimeve të kontraktuara, BQK-ja duhet të koordinoj veprimet e veta me këtë autoritet tjetër mbikëqyrës, në varësi të mundësive dhe marrëveshjeve të lidhura me këto autoritete mbikëqyrëse.

Procesi i kompletimit të vlerësimit të rrezikut është përshkruar në fazën e dytë të manualit. Duke vërejtur se shumë aspekte të procesit të vlerësimit të rrezikut mund të kompletohen nga informatat e analizuar nga stafi i divizionit të raportimit dhe analizave (off-site) me ndihmë nga stafi i divizionit të mbikëqyrjes në vend (on-site).

4.2.2 Ekzaminimi me fushëveprim të kufizuar

Nëse pas vlerësimit të rrezikut për një sigurues, BQK-ja përcaktohet se një ekzaminim me fushëveprim të kufizuar (ekzaminim i fokusuar) është i domosdoshëm, ekzaminimi do të mbulonte fushat e rrezikut ndaj të cilave BQK-ja konsideron se është ekspozuar siguruesi, duke u bazuar në atë vlerësim të rrezikut.

Pas kësaj kryhet ekzaminimi me fushëveprim të kufizuar (ekzaminimin i fokusuar) për të shqyrtuar aspektet të performancës apo situatës financiare të siguruesit, siç është identifikuar nga dhe/ose fushat specifike të operacioneve të siguruesit, siç janë identifikuar në vlerësimet e mëhershme të rrezikut.

4.3. Fushat e rrezikut për t'u ekzaminuar nga ekzamineret

Manuali është i ndërtuar sipas fushave kryesore të rrezikut që duhet të menaxhohen nga secili sigurues.

Për të kompletuar një ekzaminim të fushëveprimit të plotë të gjitha fushat e rrezikut do të ekzaminohen, ndersa ekzaminimi i fokusuar ose me fushëveprim të kufizuar do të mbulonte vetëm fushat e rrezikut ndaj të cilave BQK-ja konsideron se siguruesi është i ekspozuar, bazuar në një vlerësim të mëhershëm të rrezikut.

Rreziqet të cilat do të ekzaminohen gjatë një ekzaminimi të plotë janë si në vijim:

- Ligjor;
- Qeverisë;
- Strategjik;
- Operacional;
- Sigurues;
- Likuiditetit;
- Kreditor; dhe
- Rreziku i investimeve ose i tregut;

Këto fusha të rrezikut janë të përshkruara në më shumë detaje më poshtë.

1) Rreziku Ligjor

Një shqyrtim ligjor do të përfshijë rrezikun e humbjes që rrjedh nga kontratat e pazbatueshme dhe aktgjykimëve të pafavorshme, publicitetit negativ në lidhje me praktikat biznesore të institucionit apo paaftësisë ose jo-gatishmërisë që të respektojë ligjet, rregulloret dhe rregullat. Ky rrezik gjithashtu përfshinë pritjen që një sigurues të shfrytëzohet për shpëlarje të parave dhe financim të terrorizmit.

2) Rreziku qeverisës

Efektshmëria e bordit, menaxhmentit të lartë dhe zyrës qendrore të një institucioni në ofrimin e drejtimit strategjik dhe mbikëqyrjes së operacioneve të institucionit duhet të analizohet si pjesë e shqyrtimit të qeverisjes. Vlerësimi i mbikëqyrjes dhe qeverisjes merr parasysh strukturën dhe praktikën, aftësinë e bordit dhe menaxhmentit për të siguruar se aktivitetet kryhen në një mënyrë të sigurtë dhe të shëndoshë dhe se puna e institucionit me klientët është transparente dhe korrekte në pajtim me standardet e larta të profesionalizmit dhe praktikave të shëndosha biznesore.

Këtu duhet përfshirë efektshmëria e:

- Sistemet e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollet e brendshme në menaxhimin e rrezikut të qenësishëm në aktivitetet e institucionit;
- Funkzioni i auditimit të brendshëm në ofrimin e sigurisë për efektshmërinë dhe përmbushjen e menaxhimit të rrezikut të institucionit, kontrolleve dhe proceseve të qeverisjes; dhe
- Funkzioni i pajtueshmërisë në ofrimin e mbikëqyrjes së pavarur për menaxhmentin për zbatueshmërinë e të gjitha ligjeve, rregulloreve, kodeve të sjelljes, standardeve dhe praktikave më të mira që kanë të bëjnë me aktivitetet e institucionit në juridiksionin ku vepron ai.

3) Rreziku strategjik

Modeli i biznesit dhe strategjia e siguruesit duhet të vlerësohet për rrezik. Për shembull, cilat vendime është duke i marrë siguruesi për të ardhmen e tij që mund të ndikojnë në nivelin e rrezikut brenda tij dhe sa suksesshëm i ka implementuar siguruesi ndryshimet në të kaluarën?

4) Rreziku operacional

Një vlerësim operacional duhet të përfshijë rrezikun e humbjes që rrjedh nga operacionet komplekse, kontrolleve të brendshme jo-adekuate, proceset dhe sistemet e informimit, ndryshimeve organizative, mashtrimeve apo gabimeve njerëzore ose katastrofave të paparashikueshme (përfshirë këtu sulmet terroriste dhe fatkeqësitë natyrore).

Çfarëdo rezultati potencial i pafavorshëm, dëmi, humbje, shkeljeje, dështimi ose ndërprerjeje që rrjedh si rezultat i shfrytëzimit të harduerit kompjuterik, softuerit, pajisjeve, sistemeve, aplikacioneve dhe rrjeteve duhet të ekzaminohet. Ky rrezik është zakonisht i ndërlidhur me të metat e sistemit, gabimeve të procesimit, defekteve softuerike, gabimeve operative, prishjeve harduerike, dështimeve të sistemeve, pamjaftueshmërinë e kapaciteteve, dobësitë e sistemit dhe kontrollave, mungesat në siguri, sulmeve keqdashëse, incidenteve të hakimit, veprimeve mashtruese apo aftësive jo-adekuate për rimëkëmbje.

Rreziku i humbjes apo cenimit të konsumatorit dhe palëve që rrjedh nga praktikën e padëshiruara të sjelljes në treg nga një institucion dhe/ose përfaqësuesi i tij, dhe/ose paaftësia e tyre apo mosgatishmëria për të përmbushur kërkesat e tregut dhe sjelljes biznesore është një fushë tjetër për t'u ekzaminuar.

5) Rreziku sigurues

Rreziku sigurues përfshinë rrezikun e humbjes që rrjedh nga vendosja jo-adekuate e çmimeve, gjykimet e gabuara në përzgjedhjen, aprovimin dhe mbajtjen e rrezikut që do të sigurohet apo nënvlerësimi i detyrimeve të policës së sigurimeve.

6) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit do të thotë kur institucioni nuk është në gjendje të përmbush nevojat e rrjedhës së parave të pritura dhe të papritura të tashme dhe të ardhshme, e me këtë ndikohen operacionet e përditshme apo pozita financiare. Kjo rrjedh nga mospërputhja e maturiteteve të hyrjeve dhe daljeve të parave të gatshme.

7) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor mund të përfshijë rrezikun që rrjedh nga dështimi i një detyruesi (p.sh. huamarrësi, palëve, risiguruesit, etj.) që të performojnë në pajtim me kushtet dhe afatet të kontratës/marrëveshjes së tyre me institucionin, si dhe humbje në vlerë të aseteve të institucionit për shkak të përkeqësimit të kualitetit kreditor të detyruesit.

8) Rreziku i investimeve ose i tregut

Rreziku i tregut përfshinë efektin e pafavorshëm në vlerën e aseteve për shkak të lëvizjeve në nivelin dhe paqëndrueshmërinë e normave apo çmimeve të tregut (p.sh. normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e instrumenteve të ekuitetit, etj.) të aseteve në fjalë.

4.4. Ekzaminimi në vend - parimet

Përderisa monitorimi i vazhdueshëm mund të jetë sistematik dhe deri në një masë mund të standardizohet (për shembull një analizë e konsistencës të pasqyrave financiare, pozita e siguruesit në relacion me tregun), mbikëqyrja në vend i përshtatet specifikave të siguruesit dhe problemeve që potencialisht do të zbulohen në vend. Për këtë arsye është e vështirë të përcaktohet paraprakisht kohëzgjatja dhe detajet e sakta për secilin ekzaminim që do të kryhet në vend.

Ka shumë veprime dhe aktivitete të cilat mund të përfshihen në vizitat e ekzaminimit në vend.

4.4.1 Aktivitetet të cilat duhet të përfshihen dhe të implementohen nga stafi i BQK-së gjatë ekzaminimeve ose vizitave në vend, përfshijnë si vijon:

4.4.1.1 Vlerësimi i menaxhmentit, rreziqeve dhe sistemit të kontrolleve të brendshme

Aktivitetet e vlerësimit të menaxhmentit të siguruesit, rreziqeve dhe sistemit të kontrolleve të brendshme mund të përfshijnë:

- Shqyrtimi i procesverbaleve nga takimet e bordit të drejtorëve, raportet e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe raportet e aktuarëve;
- Analiza e strukturës pronësore dhe burimet e fondeve kapitale;
- Vlerësim i të qenurit i përshtatshëm dhe i duhur për menaxhmentin, efikasitetin e tyre dhe aftësinë e tyre për të identifikuar dhe rregulluar praktikat jo te mira menaxheriale;

- Ekzaminimi i të gjitha procedurave të brendshme aktuale dhe sistemeve të kontrollit të rrezikut të siguruesit;
- Ekzaminimi i procedurave kontabël për të zbuluar se informatat financiare dhe statistikore që dërgohen në mënyrë periodike te autoriteti rregullativ janë të besueshme ose jo dhe nëse janë në pajtim me kërkesat e rregulloreve përkatëse;
- Analizë e aktiviteteve të fundit biznese të siguruesit dhe ndërlidhjen e tyre me planin e fundit strategjik të siguruesit; dhe
- Analizë e çfarëdo ndryshimi në kategoritë kryesore të biznesit, policëmbajtësit dhe shtrirjen gjeografike të siguruesit.

4.4.1.2 Protokollet që duhet përcjellë për vizitat në vend

Gjatë fazës së ekzaminimit në vend, ekzaminuesit mbledhin informata të cilat i ndihmojnë atyre në përcaktimin e saktë të profilit të rrezikut të siguruesit. Me vënien në dispozicion të më shumë informatave, BQK gjithmonë duhet të shqyrtojë nëse këto informata do të ndërronin profilin aktual të rrezikut për atë sigurues të caktuar. Nëse po, dhe ndryshimi është për të keq, atëherë BQK mund të vendosë se nevojitet punë shtesë. Ekzaminuesit gjithashtu duhet të jenë të vëmendshëm për çfarëdo çështje që mund të ketë implikime më të gjëra për mbikëqyrjen (p.sh. çështje që ndikojnë në tërë sektorin e sigurimeve).

Çfarëdo kërkimi për informata që paraqitet gjatë procesit të monitorimit analitik (off-site), por të cilat nuk është menduar se kanë qenë aq të rëndësishme që të ngritën menjëherë me siguruesin, do të duhej të verifikohen gjatë ekzaminimit në vend.

Është shumë e rëndësishme për një ekzaminues që të mbaj komunikim të vazhdueshëm me menaxhmentin e siguruesit gjatë kryerjes së detyrave të tyre gjatë ekzaminimit. Qartësimi i një situate para konstatimit final duhet të kërkohet nga menaxherët/drejtorët relevant.

Burimet më të rëndësishme të informatave zakonisht mund të merren nga diskutimet e fokusuara me menaxhmentin e siguruesit. Është e rëndësishme inicimi i diskutimeve nga ekzaminuesi me menaxhmentin për problemet aktuale të biznesit, strategjinë e siguruesit për t'iu qasur tregut e kështu me radhë, në mënyrë që të arrihet shpalosja e informatave të plota dhe cilësore për një kohë të shkurtër.

4.5. Procesi i kompletimit të ekzaminimit në vend

Pjesa në vijim përcakton procesin që nevojitet për të kompletuar ekzaminimin në vend për një sigurues.

Të gjitha pjesët (apo fushat e rrezikut) duhet të kompletohen gjatë ekzaminimit të plotë, përderisa vetëm pjesët specifike (apo fushat e rrezikut) do të kompletohen për një ekzaminim me fushëveprim të kufizuar.

Në kuadër të kompletimit të vlerësimit të të gjitha fushave të rrezikut gjatë ekzaminimit, janë paraqitur aktivitetet e ekzaminimit si dhe aspektet tjera për tu konsideruar për secilën fushë të rrezikut.

1) Rreziku ligjor

Ky rrezik i referohet atyre rreziqeve që dalin nga lloji dhe natyra e marrëveshjeve kontraktuale të siguruesit. Kjo mund të përfshijë rrezikun që kontrata mund të mos zbatohet sipas kërkesave ligjore.

Një nga aspektet kryesore të ekzaminimit të kësaj fushe të rrezikut është për të vërtetuar nëse mund të ketë një situatë ku një sigurues mund të pësojë humbje përmes dështimit të përmbushjes së kërkesave ligjore.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të rrezikut ligjor duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i bazës të të dhënave të marrëveshjeve ligjore;
- Mbledhja, kopjimi dhe regjistrimi i detajeve për të gjitha marrëveshjet ligjore;
- Mbledhja, kopjimi dhe regjistrimi i detajeve të të gjitha marrëveshjeve të reja ose marrëveshjeve të ndryshuara nga vitet paraprake (për vitin e dytë dhe vitet vijuese);
- Shqyrtimi i procesverbalit të takimeve të bordit për të siguruar se të gjitha marrëveshjet janë aprovuar dhe nënshkruar në pajtim me statutin e siguruesit; dhe
- Kompletimi i kontrollit fizik të çfarëdo asetëve që janë të mbuluara nga këto marrëveshje ligjore.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

- A mund të sigurohen dhe kuptohen informatat për secilën kontratë të nënshkruar nga siguruesi. A ka ndonjë faktor rreziku të ndërlidhur me këto informata?
- A janë marrëveshjet ligjore në pajtim me kornizën ligjore në fuqi? A nevojitet mendimi profesional i ndonjë pale të tretë për sqarime?
- A i mbulojnë marrëveshjet ligjore të mbledhura të gjitha marrëveshjet kontraktuale biznesore dhe siguruese të cilat i ka siguruesi?
- A janë të përshtatshme marrëveshjet ligjore për siguruesin (p.sh. a janë në pajtim me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve qenësore në biznesin e tij?)
- A ofrojnë mbrojtje efektive për siguruesin marrëveshjet që janë të ndërlidhura me kontraktimin e shërbimeve?
- A ekziston manual procedural për atë se si duhet të hartohen marrëveshjet ligjore dhe a azhurnohen këto manuale në mënyrë të rregullt?
- A aprovohen të gjitha marrëveshjet ligjore në pajtim me statutin e siguruesit?
- Sa janë të efektshme marrëveshjet ligjore në mbrojtjen e siguruesit?
- A janë të gjitha asetet, detyrimet dhe kërkesat operationale të biznesit të rëndësishme, të mbuluara si duhet përmes marrëveshjeve ligjore të hartuara?
- A janë të gjitha kontratat e agjentëve dhe ndërmjetësuesve/brokerave të lidhura përmes marrëveshjeve ligjore?

- A ka njohuri të mjaftueshme personeli për marrëveshjet ligjore që kanë ndikim në punën e tyre dhe të siguruesit?
- A ofron ndonjë ekspert ligjor këshilla të pavarura për menaxhmentin mbi përshtatshmërinë e secilës marrëveshje ligjore para se siguruesi të zotohet për secilën marrëveshje?

2) Rreziku qeverisës

Rreziku qeverisës përfaqësohet përmes dështimit të bordit për të menaxhuar dhe qeverisur biznesin. Nga bordi kërkohet që të balancoj interesat e policëmbajtësve dhe aksionarëve.

Përveç përmbledhjes të rrezikut kryesor në paragrafin e mësipërm, aspektet tjera të rrezikut qeverisës përfshijnë rrezikun që rezulton nga kualiteti i menaxhimit të siguruesit, gjendja e qeverisjes korporative dhe kultura e përgjithshme e përmbushjes.

Aspektet për t'u konsideruar përfshijnë; integritetin dhe përvojën e menaxhmentit dhe përshtatshmërinë e tyre me biznesin, operacionet e ekipit ekzekutiv të udhëheqjes, bordin e drejtorëve dhe drejtorët jo-ekzekutiv si dhe komitetet e bordit.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të rrezikut qeverisës duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i strategjisë, politikave dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut;
- Mbledhja, kopjimi dhe shqyrtimi i CV-ve të menaxhmentit të lartë dhe personelit të pajtueshmerisë, auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut;
- Shqyrtimi i dokumenteve të bordit dhe takimeve të komiteteve për raportimin dhe menaxhimin e rrezikut;
- Intervistimi i anëtarëve të bordit, menaxhmentit të lartë, menaxherit të rrezikut dhe auditorit të brendshëm për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut;
- Mbledhja, kopjimi dhe shqyrtimi i raporteve të auditorit të brendshëm;
- Mbledhja dhe kopjimi i skemës organizative; dhe
- Mbledhja dhe kopjimi i regjistrit të ankesave.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

- përshtatshmëria e politikave dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut;
- rreziku që rezulton nga raportimi dhe struktura e personelit në mes të menaxhmentit të lartë dhe bordit të drejtorëve;
- ndarja e duhur e detyrave në mes të funksioneve që kanë natyrë të marrjes së rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut;
- natyra e rreziqeve që dalin nga funksioni i pajtueshmerisë (këto do të përfshijnë mandatin, strukturën, metodologjinë e punësimit, linjat raportuese dhe efektshmëria).

Ekzaminuesit e BQK-së duhet të vënë theks të shtuar në atë se cilat janë kontrollet e vendosura për pajtuesmeri, menaxhim të rrezikut për funksionet specifike të cilat mund të kontraktohen jashtë dhe gjithashtu si menaxhohet konflikti i interesit të siguruesit.

Aspektet tjera që duhet përfshirë janë:

Struktura qeverisëse

Ofroni një përmbledhje përshkruese të strukturës organizative, përfshirë këtu së paku:

- Një përshkrim të adekuatshmërisë së sistemit qeverisës për profilin e rrezikut të siguruesit ose grupit, përfshirë një deklaratë të adekuatshmërisë së këtij sistemi;
- Çfarëdo ndryshimi material në strukturën qeverisëse që janë bërë gjatë vitit;
- Struktura e organit administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës, përfshinë një përshkrim të roleve dhe përgjegjësi kryesore si dhe një përshkrim të shkurtër të përgjegjësi të tyre aty ku komitetet relevante ekzistojnë, si dhe ndarjen e përgjegjësi, duke detajuar komitetet specifike dhe personelin si dhe rolet dhe përgjegjësitë kryesore të tyre; dhe
- Nëse siguruesi është pjesë e një grupi ose një konglomerati financiar, një përshkrim i nivelit të lartë në lidhje me strukturën korporative të atij grupi.

Qeverisja e rreziqeve kryesore

Përshkruaj qasjen dhe procesin të cilin e ka vendosur siguruesi për secilën kategori të qeverisjes së rreziqeve kryesore, kjo do të duhej të përfshinte komente mbi:

- Si definohet secila kategori e rreziqeve materiale;
- Si definohet secili nivel i tolerancës së rrezikut;
- Procesin e delegimit të tolerancës së rrezikut të menaxhmenti;
- Përshkruani procesin e monitorimit të rrezikut aktual të marrë kundrejt tolerancës së rrezikut;
- Përshkruani procesin e pranimi të ndryshimeve të ndodhura; dhe
- Detajet e ndryshimeve materiale të politikave dhe/ose proceseve të qeverisjes ose menaxhimit të rrezikut gjatë periudhës raportuese.

I përshtatshëm dhe i duhur (fit and proper)

Bëni përshkrim përmbledhës të:

- Procesit për vlerësimin e “i përshtatshëm dhe i duhur” të personave që në mënyrë efektive menaxhojnë siguruesin dhe personave përgjegjës për funksionet tjera kyçe; dhe
- Një përshkrim të kërkesave specifike minimale të BQK-së për aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën që është e aplikueshme për personat që në mënyrë efektive e menaxhojnë siguruesin, si dhe një përmbledhje për atë se si stafi i funksioneve kyçe i përmbush këto kërkesa.

Strategjia dhe politikat e rrezikut

- Bëni një përshkrim përmbledhës për strategjinë dhe politikat e rrezikut që i ka siguruesi për t'u siguruar se është në përputhje me apetitin e vet për rrezik;
- Përshkruani se si sistemi i menaxhimit të rrezikut i përbërë nga strategjitë, proceset dhe procedurat e raportimit është në gjendje të identifikoj, matë, monitoroj, menaxhoj dhe raportoj, mbi baza të vazhdueshme;
- Shqyrtimi dhe regjistrimi se rreziqet vlerësohen në nivel individual dhe të përgjithshëm, ndaj të cilëve siguruesi mund ose është i ekspozuar, dhe çfarëdo dëshmie e ndër-lidhshmërisë së rreziqeve;
- Një përshkrim se si janë të integruara proceset e rreziqeve në procesin e menaxhmentit dhe kornizën e vendimmarrjes së siguruesit; dhe
- Një përshkrim se si proceset e rreziqeve evidentohen dhe dokumentohen brenda siguruesit dhe si shqyrtohen ato në mënyrë të pavarur.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Përshkruani (duke përdorur një format përmbledhës) se si funksionon sistemi i brendshëm i kontrolleve të siguruesit dhe përshkruani pse ky sistem është i përshtatshëm për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit, përfshi këtu:

- Përshkrimin e procedurave administrative dhe kontabël të cilat janë në zbatim
- Detajoni se si sistemi i brendshëm i kontrolleve merret me kërkesat mbi delegimin e qartë të përgjegjësisë, linjave raportuese dhe ndarjen e detyrave;
- Detajoni se si funksionon puna e funksionit të pajtueshmerisë.

Auditimi i brendshëm

Përshkruani (duke përdorur një format përmbledhës) se si operon funksioni i auditimit të brendshëm përfshirë këtu, se si ofron siguri për mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme brenda siguruesit ose grupit.

- Përshkruani në hollësi se si funksioni i auditimit të brendshëm mban pavarësinë dhe objektivitetin e vet nga aktivitetet që i shqyrton.
- Shqyrtimi dhe përshkrimi se si e ekzaminon auditimi i brendshëm përmbushjen e aktiviteteve të siguruesit;
- Përmbledhje e auditimeve të kryera gjatë periudhës dhe plani i siguruesit për auditimet e ardhshme;
- Ofro një përmbledhje të gjetjeve të raportuara te bordi dhe shfrytëzimi i tyre i auditimit të brendshëm dhe raporteve të auditimit (p.sh. veprimet e ndërmarra ose rekomandimet e bëra); dhe

- Shqyrtimi dhe detajimi i çfarëdo veprimi të ndërmarrë për përmirësimin e kornizës kontrolluese dhe zbutja e rrezikut të identifikuar përmes punës së auditimit të brendshëm që nga data e fundit e raportimit.

Funksioni aktuarial

Përshkruani (duke përdorur një format përmbledhës) se si implementohet funksioni aktuarial, duke përmbledhur fushat kryesore të përgjegjësisë dhe duke përshkruar se si sigurohet që funksioni aktuarial është objektiv dhe i lirë nga ndikimi i funksioneve tjera ose organeve administrative, menaxheriale apo mbikëqyrëse.

Detajet e aktiviteteve të funksionit aktuarial të siguruesi duhet të shqyrtohen dhe përshkruhen secila nga fushat vijuese:

- Si bëhet kalkulimi i provizioneve teknike;
- Përshtatshmëria e metodologjisë dhe modelet që përdoren si dhe vlerësimet që bëhen në kalkulimin e provizioneve teknike;
- Vlerësimi i mjaftueshmërisë dhe kualitetit të të dhënave të përdorura në kalkulimin e provizioneve teknike;
- Shqyrtimi i përfshirjes aktuariale në zhvillimin dhe shqyrtimin e politikave të marrjes në sigurim të siguruesit;
- Shqyrtimi i përfshirjes aktuariale në zhvillimin dhe shqyrtimin e marrëveshjeve të risigurimit; dhe
- Shqyrtimi i përfshirjes aktuariale në zhvillimin dhe shqyrtimin e implementimit të efektshëm të sistemit të menaxhimit të rrezikut, në veçanti në lidhje me modelin e rrezikut që përdoret në kalkulimin e kërkesave për kapital.

Konsiderimet tjera qeverisëse

Konsiderimet tjera qeverisëse përfshijnë:

- A ka bordi njohuri të plotë, aftësi dhe përvojë adekuate për të mbikëqyrur siguruesin në mënyrë të efektshme?
- A janë drejtorët e pavarur jo-ekzekutiv të bordit të përgatitur dhe kompetent?
- A ka instaluar bordi sistem adekuat dhe të efektshëm të kontrolleve të brendshme i cili përfshin monitorimin e çfarëdo funksioni të kontraktuar nga jashtë?
- A ka dokumentuar menaxhmenti rreziqet biznesore dhe kontrollet e dizajnuara për të zbutur rreziqet e tilla (p.sh. përdorimi i matricës të kontrollit të rrezikut)?
- A ka qasje bordi i drejtorëve në informatat për siguruesin, si dhe a kërkon dhe pranon informata shtesë dhe i analizon ato.
- A është duke operuar në mënyrë të pavarur funksioni i auditimit të brendshëm dhe a ka qasje të drejtpërdrejt te bordi?

- A ka caktuar menaxhmenti, zyrtar të pajtueshmërisë për monitorimin e pajtueshmërisë me rregulloret e BQK-së dhe aktet e brendshme nën-ligjore?
- A i raporton zyrtari i pajtueshmërisë bordit të drejtorëve dhe a i njofton ata për çfarëdo dobësie të rëndësishme?
- Sa efektshëm monitoron dhe raporton zyrtari i pajtueshmërisë te bordi i drejtorëve?
- A ka dokumentuar dhe aprovuar bordi kontrollin për t'u siguruar se ka procedura të mjaftueshme për të luftuar aktivitetet e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit?
- Sa efektshëm monitoron bordi nivelet e kapitalit dhe shqyrton nevojat e ardhshme për kapital gjatë aprovimit të planit të biznesit?
- A i cakton bordi politikat që adresojnë konfliktin e interesave, trajtimin korrekt të policëmbajtësve dhe ndarja e informatave me akterët dhe a i shqyrtojnë në mënyrë të rregullt këto politika?
- A janë të përshtatshme strategjia, politikat dhe proceset menaxheriale me madhësinë dhe natyrën e biznesit të siguruesit?
- Sa janë në dijeni anëtarët e bordit dhe personeli i lartë për përgjegjësitë e tyre në menaxhimin e rrezikut dhe a janë plotësisht të familjarizuar me proceset që nevojiten për të menaxhuar rrezikun?
- A është kujdesur sa duhet menaxhmenti që të mos tejkaloj kufijtë e ekspozimit mbi një rrezik të vetëm siç është definuar me kërkesat e BQK-së?

3) Rreziku strategjik

Ky rrezik përfshinë modelet e biznesit dhe strategjinë për siguruesin, këto rreziqe mund të zberthehen tutje në faktorë të rrezikut siç janë lloji i klientit, produktet dhe tregjet e synuara nga ana e siguruesit.

Kualiteti i strategjisë biznesore dhe plani i saj mund të shtojë rrezikun për siguruesin në veçanti në drejtim të plotësisht të strategjisë. Po ashtu, mund ta implikoj atë në rreziqe strategjike varësisht nga përvoja e siguruesit në implementimin e planeve të kaluara strategjike.

Komponentët tjerë të rëndësishëm të rrezikut strategjik që duhet marrë parasysh përfshijnë lokacionin e klientëve, rrezikun e ndërlidhur me burimet aktuale të biznesit dhe mekanizmat e distribuimit të përdorur nga siguruesi.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit për rrezik strategjik duhet të ndërmerren aktivitetet si në vijim:

- Shqyrtimi i planit strategjik dhe biznes planeve të siguruesit;
- Shqyrtimi i dokumentacionit dhe proceseve që janë të ndërlidhura me produktet e siguruesit;
- Shqyrtimi i bazës së të dhënave të policëmbajtësve;

- Shqyrtimi i raporteve të projekteve të ndërlidhura me implementimin e veprimeve strategjike gjatë vitit të kaluar; dhe
- Intervistimi i menaxhmentit të lartë dhe bordit të drejtorëve.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

- Shqyrtimi dhe vlerësimi i strategjive për të siguruar se siguruesi ka për qëllim të respektoj ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
- Se a janë qëllimet e siguruesit në pajtim me strategjinë e propozuar. Kjo do të duhej të përfshinte qëllimet financiare dhe jo-financiare. A mund të përcaktohen dhe detajohen nga këto objektiva, zhvillimet e mundshme të ardhshme për shqyrtime të ardhshme nga stafi i BQK-së?
- Përveç strategjisë a ka ndonjë plan mbështetës të vazhdimësisë së biznesit? Sa praktik është ky plan? A janë marrë parasysh rreziqet që renditën në planin strategjik, ambientin në të cilin është duke operuar siguruesi?
- Sa detaje mund të nxirren për biznesin dhe detyrimet e marrjes në sigurim të siguruesit. Çfarë analiza mund të bëhen në linjat e biznesit të siguruesit për të përcaktuar trendët në linjat kryesore të biznesit?
- Një përshkrim i detajuar për secilin aktivitet biznesor dhe burimet e fitimit ose humbjes brenda siguruesit.
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i bazës së policëmbajtësve të siguruesit. Identifikimi i rreziqeve potenciale brenda bazës së të dhënave dhe identifikimi se si çfarëdo ndryshimi në bazën e policëmbajtësve mund të ndikoj në biznesin e siguruesit.
- Intervistimi i rregulltë i personelit të lartë dhe drejtorëve të caktuar mbi progresin e biznesit në krahasim me planet dhe sigurimi i këndvështrimeve të tyre mbi ambientin e sigurimeve në Kosovë.
- Si i kryen menaxhmenti analizat për të kuptuar të hyrat e biznesit, klientët dhe produktet që janë duke u shitur? A mjafton kjo analizë?
- Sa proaktiv është siguruesi në menaxhimin e bazës së të dhënave për klientët? A është e azhurnuar dhe a reflekton drejtimin strategjik të siguruesit?
- A zhvillohen të gjitha produktet e reja në pajtim me politikat dhe proceset e siguruesit, a janë të përshtatshme për nivelet e rrezikut të tij?

4) Rreziku operacional

Rreziku operacional del nga problemet në performancë të funksioneve dhe proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të rezultojë nga mungesat apo dobësitë në kontrollet ose proceset e brendshme, dështimeve teknologjike, gabimeve njerëzore apo mos-ndershmërisë dhe katastrofave natyrore. Aspektet kryesore të këtij rreziku janë ekspozimi i siguruesit ndaj marrjes në sigurim dhe natyrës së marrëveshjeve kontraktuale të tij në lidhje me marrjen në sigurim.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të rrezikut operacional duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i politikave të burimeve njerëzore, regjistrat e trajnimeve, dosjet e pagave dhe kodi i mirësjelles së personelit;
- Shqyrtimi i dokumentacionit dhe proceseve të ndërlidhura me planin e vazhdimësisë së biznesit të siguruesit;
- Shqyrtimi i të gjitha marrëveshjeve dhe rregullimeve të kontraktimit të jashtëm;
- Shqyrtimi i strategjisë të TI-së, planet biznesore të TI-së dhe zhvillimi i TI-së i implementuar dhe propozuar për vitin e ardhshëm;
- Shqyrtimi i rrjedhës së informatave nga personeli te menaxhmenti i lartë dhe nga menaxhmenti i lartë te bordi i drejtorëve; dhe
- Intervistimi i menaxhmentit të lartë, specialistët teknik të kontraktuar nga jashtë siç janë menaxherët e TI-së.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

- Marrëveshjet për vazhdimësi të biznesit;
- Mbështetja dhe kontrolli i çfarëdo pale të tretë që kontraktohet për të kryer çfarëdo shërbimi të kontraktuar për siguruesin;
- Punëtorët në relacion me procesin e rekrutimit, trajnimit, kërkesave për certifikim, kompensimit dhe proceset disiplinuese;
- Saktësia, fajllimi dhe adekuatshmëria e informatave për menaxhmentin;
- Mbrojtja e konfidencialitetit dhe shënimeve personale të klientëve;
- Integriteti i sistemeve të TI-së; dhe
- Integriteti dhe procesi i menaxhimit të dëmeve.

Sistemet e TI-së

- Përshkrimi i infrastrukturës së TI-së dhe sigurisë së sistemeve të TI-së.
- Detajimi i planifikimit emergjent dhe planeve të rimëkëmbjes për sistemin e TI-së të siguruesit.
- A është sistemi i TI-së dhe baza e të dhënave e siguruesit e përshtatshme për madhësinë dhe natyrën e biznesit të tij? A përkrah sistemi rrjedhë të rregullt dhe konsistente të informatave për: drejtorët, menaxhmentin e lartë, BQK-në dhe personelin e siguruesit?
- A e marrin parasysh kontraktorët e jashtëm planin e vazhdimësisë së biznesit që e ka siguruesi?
- Detajet e ofruesit të shërbimeve për cilindo shërbim të kontraktuar nga jashtë dhe si e siguron vetën siguruesi që ofruesi i shërbimeve është kompetent për t'ia ofruar shërbimin e kontraktuar.

- A merr përgjegjësi për të gjitha çështjet e ndërlidhura me TI ndonjë menaxher i TI-së me përvojë?
- A janë dokumentuar të gjithë sistemet e TI-së si dhe ndërlidhja (interface) mes tyre?
- A ruhen (back-up) sistemet e TI-së në baza ditore?
- A është krijuar një plan i rimëkëmbjes nga katastrofa dhe vazhdimësisë së biznesit dhe a testohet në mënyrë periodike?

Politikat e burimeve njerëzore

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të politikës dhe funksionimit të departamentit/njesisë së burimeve njerëzore duhet të shqyrtohen:

- Sa efektshëm transmetohen politikat e burimeve njerëzore te personeli, a është në dijeni personeli për të drejtat dhe detyrimet e tyre, a krijojnë ndonjë rrezik politikat e burimeve njerëzore për siguresin, si dhe a janë të përditësuara në pajtim me kornizën ligjore në fuqi?
- Si menaxhohet procesi i përpilimit të listës së pagave, dhe a bëhet autorizimi nga Shefi i Financave para ekzekutimit të tyre.
- A është siguresi në rrezik në fushat specifike teknike duke pasur parasysh nivelin aktual të ekspertizës në rolet specifike teknike dhe realizimin e detyrave sipas përshkrimit të vendeve të punës?
- A është përcaktuar me politikë apo procedurë, mënyra e kompensimit për drejtorët dhe menaxhmentin e lartë dhe stafin në tërësi, vlerësimi i performances dhe procesi i avancimit të tyre.
- Të gjitha kërkesat e reja për punë përfshijnë përshkrimin e dokumentuar të vendit të punës së bashku me aftësitë e nevojshme.
- Kompensimi dhe pagesa e bonuseve për personelin reflekton performancën dhe përgjegjësitë e tyre.

Operacionet

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të fushës së operacioneve duhet të shqyrtohen:

- Sa efektive janë vizitat periodike të menaxhmentit nëpër filiala dhe a janë adekuate raportet mbi mjaftueshmërinë e sistemeve dhe kontroleve efektive?
- A janë duke marrë informata me kohë menaxhmenti i lartë dhe bordi i drejtorëve që do t'i lejonte ata të marrin vendime efektive?
- A ekzistojnë manuale për procedurën e dëmeve dhe a ka kontroll të azhurnuar e të autorizuar mbi pagesën e dëmeve?
- Si e aplikon menaxhmenti një qasje të kujdesshme?

- A është kalkulimi i rezervave të “dëmeve të njohura por të pa paguara” në pajtim me kërkesat e BQK-së?
- A i ka dokumentuar menaxhmenti kontrollet e tyre për të parandaluar dëmet mashtruese?
- A kryen menaxhmenti analiza për të kuptuar nivelin e dëmeve, pagesat e dëmeve, frekuencën e dëmeve, koston mesatare të dëmeve, kostoja e rregullimit të jashtëm të dëmeve?
- Si i shqyrton menaxhmenti rikthimet nga subrogimet dhe si e konsideron nevojën për çfarëdo provizioni kundrejt rikthimeve.

5) Rreziku sigurues

Ky rrezik referohet edhe si rrezik i marrjes në sigurim. Bëhet evident kur dëmet e pagueshme janë më të mëdha se primet që janë mbledhur.

Kjo merr parasysh rreziqet që dalin nga lloji dhe natyra e rrezikut të marrjes në sigurim nga siguruesi. Këto mund të përfshijnë apetitin e rrezikut të siguruesit, natyrën e ekspozimit të marrjes në sigurim të përfshirë në produktet dhe shërbimet e ofruara si dhe shtrirjen e mbulesës risiguruese.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit për rrezikun sigurues duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i dokumentacionit dhe proceseve që kanë të bëjnë me marrjen në sigurim të siguruesit.
- Shqyrtimi i procedurave dhe dokumentacionit të risigurimit
- Shqyrtimi i të gjitha marrëveshjeve dhe rregullimeve për risigurim.
- Shqyrtimi i aspekteve financiare të regreseve.
- Intervistimi i menaxhmentit të lartë, menaxherin e marrjes në sigurim dhe menaxherin përgjegjës për risigurim.
- Vërtetimi i pavarur i informatave me risiguruesit.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

Përshkruani performancën e marrjes në sigurim të siguruesit ose grupit gjatë vitit dhe përfshini, së paku:

- Informatat mbi performancën e marrjes në sigurim të siguruesit ose grupit sipas linjave të biznesit dhe zonës gjeografike;
- Informatat mbi shpenzimet e marrjes në sigurim sipas linjave të biznesit dhe zonës gjeografike gjatë vitit, krahasuar me vitin paraprak; dhe
- Për siguruesit që i takojnë ndonjë grupi, informatat mbi operacionet dhe transaksionet ndërgrupore relevante brenda grupit.

- Detajet e performancës së marrjes në sigurim të siguresit sipas linjave të biznesit në raport me planin dhe faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në devijimin nga plani (p.sh. dëme të mëdha, të papritura, vëllimi i primeve);
- Detajet mbi shpenzimet e marrjes në sigurim gjatë vitit krahasuar me të kaluarën dhe pritjet për vitet e ardhshme përfshirë këtu vlerësimin për rrjedhën e dëmeve dhe mashtrimet e policëmbajtësve;
- A janë dokumentuar dhe aprovuar udhëzuesit për marrje në sigurim
- Projeksionet e performancës të marrjes në sigurim të siguresit gjatë periudhës së planifikimit biznesor me detajet mbi faktorët e konsiderueshëm që mund të ndikojnë në performancën e marrjes në sigurim siç janë pagesat materiale të ditura ose të pritura për dëmet;
- Një analizë për performancën e përgjithshme të marrjes në sigurim të siguresit.

Programet e risigurimit:

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të programit të risigurimit duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- A ka menaxhmenti ndonjë proces për të konsideruar adekuatshmërinë e programit të vet risigures ?
- Si e ka dokumentuar menaxhmenti programin e vet të risigurimit?
- Cilët janë proceset për regjistrimin dhe identifikimin e rikthimeve të risigurimit për marrëveshjet proporcionale dhe jo-proportionale për dëmet e paguara, dëmet e papaguara dhe IBNR? Si regjistrohen marrëveshjet e risigurimit ku asetet e risigurimit zbulohen ndaras?
- Sa efektiv është menaxhmenti në monitorimin e nivelit të përgjithshëm të provizioneve teknike?
- A ekziston një metodë për agregimin dhe shqyrtimin e provizioneve teknike (rezerva e primit të pafituar UPR dhe IBNR) së paku një herë në tre muaj?

6) Rreziku i likuiditetit

Aspekti kryesor i këtij rreziku është aftësia e siguresit për të menaxhuar paratë e gatshme në aktivitetet e përditshme të tij.

Në esencë rreziku i likuiditetit del nga lloji dhe natyra e likuiditetit të siguresit apo përzierjes së aseteve dhe detyrimeve. Këtu përfshihet korniza e menaxhimit të likuiditetit dhe përbërja e likuiditetit për të mundësuar përmbushjen e të gjitha obligimeve operationale dhe financiare të biznesit edhe nga perspektiva e përditshme edhe në situata të krizës.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit të rrezikut të likuiditetit duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i politikave dhe manualeve të proceseve për likuiditetin e siguresit.
- Shqyrtimi i politikave dhe planeve investive të siguresit

- Shqyrtimi i marrëveshjeve të investimeve, ku përfshihen, lloji, afatet, normat e interesit dhe të dhënat tjera relevante.
- Analizimi i kthimit nga portfolio e likuiditetit dhe përzierja e asetëve me detyrimet si dhe ndikimi i tyre në rrezikun e siguruesit.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

Aspektet për t'u konsideruar gjatë marrjes së informatave që nevojiten për të krijuar dhe zhvilluar bazën e të dhënave dhe për t'u përdorur si informatë për matricën e vlerësimit të rrezikut dhe/ose krijimin e raporteve të ekzaminimit për secilën sigurues:

- Një përshkrim se si e menaxhon siguruesi rrezikun e vet të likuiditetit (përfshirë analizat e maturitetit, stres testet dhe ndikimet në rast të ndryshimit të normave të interesit).
- Një shqyrtim të kthimeve dhe rreziku relativ i investimeve që përbëjnë portfolion e likuiditetit.
- Detajet e investimeve të bëra për qëllime të likuiditetit me analiza të kompletuara për trendet tremujore për të përcaktuar se sa të përshtatshme janë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguruesit.
- A është politika e likuiditetit e përshtatshme për madhësinë dhe rrezikun e siguruesit?
- A janë të gjitha fondet e investuara për qëllime të likuiditetit të investuara në mënyrën e duhur dhe në pajtim me politikat?
- A mund të verifikohen dhe balancohen të gjitha investimet në asete likuide?
- A ka menaxhmenti proces adekuat për të siguruar se të gjitha investimet janë të autorizuar nga komiteti investimeve dhe bordi drejtues i siguruesit?

7) Rreziku kreditor

Rreziku identifikohet si rrezik që ka të bëjë me palët kontraktuese të lidhura me aktivitetin e siguruesit; për shembull risiguruesi dhe pagesa e primeve nga policëmbajtësit.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit për rrezikun kreditor duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i politikës kreditore të siguruesit me palët dhe organizatat tjera të rëndësishme me të cilat bënë biznes.
- Shqyrtimi i rregullimeve për risigurim në relacion me rrezikun kreditor.
- Analizimi i librit të debitorëve dhe kompletimi i analizave mbi debitorët të cilët duket se kanë natyrë të rrezikut të lartë.
- Shqyrtimi i procesit kreditor të siguruesit dhe intervistimi i personelit që është përgjegjës për fushën kreditore.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

- Shqyrtimi dhe analizimi i orarit/planit të debitorëve dhe detajimi i trendëve dhe çfarëdo ndryshimi ndikues.

- Krahasimi i listës së debitorëve me atë të siguruesve tjerë, a ka emra të përbashkët që shfaqen në orarin/planin e debitorëve të siguruesve tjerë?
- Sa efektive dhe efikase janë pagesat nga risiguruesit?
- Sa efektshëm implementohet dhe menaxhohet politika kreditore e siguruesit?
- A është e përshatshme politika kreditore e siguruesit për madhësinë dhe rrezikun e tij?
- A mbliidhen të gjitha fondet nga palët brenda një kohe të pranueshme?
- A punon efektshëm personeli që është përgjegjës për menaxhimin e politikës kreditore dhe a i ofrojnë raportim të saktë menaxhmentit?

8) Rreziku investues (ose i tregut)

Rreziku bëhet evident kur siguruesi ka humbje të vlerës në asetet e veta financiare, se si i investon siguruesi asetet e fondit të jetës apo fondeve që i përkasin siguruesit në formën e rezervave apo kapitalit mund të ketë ndikim të madh në profilin e rrezikut të tij.

Aktivitetet e ekzaminimit

Gjatë kryerjes së ekzaminimit për rrezikun investues (ose të tregut) duhet të ndërmerren aktivitetet vijuese:

- Shqyrtimi i politikës investuese të siguruesit.
- Shqyrtimi i portfolios së investimeve dhe krahasimi i saj me politikat investuese.
- Analizimi i rëndësisë të politikës krahasuar me madhësinë dhe rrezikun e siguruesit.
- Shqyrtimi i procesit të investimeve të siguruesit dhe intervistimi i personelit përgjegjës për fushën e funksionit të investimeve.
- Sigurimi i verifikimit të pavarur për asetet e investuara.
- Analizimi i kthimeve nga investimet.

Aspektet tjera për t'u konsideruar

- Përshkruani performancën e siguruesit ose të grupit në investime gjatë vitit, dhe përfshini së paku:
 - a) Informata mbi fitimin ose humbjen nga investimet;
 - b) Informata që tregojnë fitimin ose humbjen e njohur drejtpërdrejtë në ekuitet;
 - c) Informata për transaksionet me aksionarët dhe anëtarët e organeve administrative, menaxheriale apo mbikëqyrëse, transaksionet ndër-grupore, shpërndarja për aksionarët dhe ndarja e fitimit me policëmbajtësit;
 - d) Ndikimi i amortizimit dhe humbjes së vlerës në asetet e paprekshme/të prekshme dhe instrumentet financiare mbi performancën e investimeve; dhe
 - e) Informatat mbi shpenzimet për investime të ndodhura gjatë vitit, krahasuar me vitin paraprak dhe arsyet e lëvizjeve;
 - f) Një vlerësim se si siguruesi i ka investuar asetet e veta në pajtim me principin e maturisë.

- g) Një vlerësim se si menaxhmenti i lartë merr vendim për investime si dhe vlerësimet kryesore të bëra në lidhje me normat e interesit, kurset e këmbimit valutor dhe indekset e tregjeve.
- h) A mbahen me rregull takimet e komitetit të investimeve si dhe a i shqyrton transaksionet e investimeve? A përgatitet ndonjë material para se të mbahen takimet e komitetit të investimeve dhe a mbahet procesverbali?
- i) A është e politika e investimeve të siguruesit e përshtatshme për madhësinë dhe rrezikun e tij?
- j) A mund të verifikohet se investimet janë autorizuar nga personat përgjegjës për aprovimin paraprak të tyre?
- k) A mundet menaxhmenti të përdorë proceset e veta për të siguruar se të gjitha investimet janë të barazuara me konfirmimet nga palët e treta së paku një herë në muaj?

Vlerësimi i profilit të rrezikut të siguruesit duke ndjekur qasjen e përshkruar në hapat më lartë paraqitet në mënyrë të përmbledhur në matricën e rrezikut sikurse në Shtojcën 1 më poshtë.

Shtojca 1: Shembull i matricës së rrezikut

Emri i siguruesit: _____																	
Vlerësimi i rrezikut me / /																	
Aktivitetet e rëndësishme *	Materialiteti	Rreziku i qenësishëm							Kualiteti i menaxhimit të rrezikut						Neto Rreziku	Drejtimi i rrezikut	
		Kreditor	Tregu	Likuiditeti	Operacional	Ligjor dhe rregullativ	Strategjik	Sigurues	Menaxhimi operacional	Analizat financiare	Përbushja	Auditimi i brendshëm	Menaxhimi i rrezikut	Menaxhmenti i lartë			Mbikëqyrja e bordit
Marrja në sigurim	3	2	3	3	2	2	2	2	2	1	3	1	1	2	2	3	
Dëmet	2	3	2	3	2	3	2	3	2	2	2	1	1	1	1	3	
Investimet	2	3	2	4	3	2	4	2	1	1	1	1	1	1	1	4	
Produktet e reja	1	2	3	2	3	3	3	2	1	2	2	1	1	2	2	3	
Biznesi i ri	1	3	3	3	3	2	3	2	2	3	3	1	1	3	2	3	
Nota e përgjithshme**									2	2	2	1	1	2	2	2	

*Përshkrimi i secilit aktivitet të rëndësishëm mund të ketë më shumë ose më pak se 6 aktivitete të rëndësishme që vlerësohen;

** 1 - ulët (U), 2 - i mesëm (M), 3 - mbi mesatare (MM) dhe 4 - i lartë (L); 1 – i fortë (F), 2 – i pranueshëm (P), 3 – nevojë për përmirësim, dhe 4 – dobët;

KAPITALI	euro	FITIMET	euro
NOTA E PËRBËRJES Nota 3 është “nivel i rrezikut mbi mesatare”		DREJTIMI I RREZIKUT N/A vlerësimi i parë	KORNIZA KOHORE 12 muaj

5. Vlerësimi sipas sistemit CAMELS

Pjesët në vijim përmbajnë përkufizimet e vlerësimeve të përgjithshme dhe të komponentëve, si dhe përshkrimet dhe përkufizimet për tetë komponentet.

5.1. Vlerësimi i përgjithshëm

5.1.1 Vlerësimi i përgjithshëm 5 – Siguruesit në këtë grup janë të shëndoshë në çdo aspekt dhe në përgjithësi kanë komponentët e vlerësuar me 5 dhe 4. Çfarëdo dobësie është e vogël dhe mund të përballohet në mënyrë të zakonshme nga menaxhmenti. Këta sigurues janë në gjendje të përballojnë përkeqësimet e kushteve të biznesit dhe janë rezistuese nga ndikimet e jashtme, siç është jostabiliteti ekonomik në zonën e tyre të afarizmit. Këta sigurues janë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe rregulloret. Siguruesit në këtë grup shfaqin performancë dhe praktika të forta të menaxhimit të rrezikut pavarësisht madhësisë së tyre, ndërlikueshmërisë dhe profilit të rrezikut, dhe nuk ka asnjë arsye për shqetësim mbikëqyrës.

5.1.2 Vlerësimi i përgjithshëm 4 - Siguruesit në këtë grup janë të qëndrueshëm. Që siguruesi të pranojë këtë vlerësim, në përgjithësi asnjë komponentë e vlerësuar nuk mund të jetë më i ultë se klasifikimi/nota 3. Vetëm dobësitë mesatare janë prezente dhe janë brenda aftësive dhe gatishmërisë së Bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit për t'i korrigjuar. Këta sigurues janë stabil, të aftë dhe të qëndrueshëm t'i përballojnë lëkundjet e afarizmit. Këta sigurues janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret. Praktikrat e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut janë të mira në lidhje me madhësinë e siguruesit, ndërlikueshmërinë, dhe profilin e rrezikut. Nuk ka shqetësime materiale nga ana e institucionit mbikëqyrës.

5.1.3 Vlerësimi i përgjithshëm 3 - Siguruesit në këtë grup janë relativisht të mirë. Ata ekspozojnë një shkallë të vëmendjes mbikëqyrëse në një apo më shumë fusha (lëmi) të komponentëve. Këta sigurues ekspozojnë një kombinim të mangësive që mund të radhiten prej atyre mesatare në ato të ashpra (mëdha); megjithatë, madhësia e mangësive, zakonisht nuk do të shkaktojë që komponenti të klasifikohet më ashpër (keq) se klasifikimi/nota 2. Menaxhmentit mund t'i mungojë aftësia apo vullneti që në mënyrë efektive t'i adresojë ato dobësi brenda kornizave të përshtatshme kohore. Siguruesit në këtë grup janë më pak të aftë që t'i përballojnë një fluksi më të madh negativ të biznesit dhe janë më të prekshme (ndjeshme) nga ndikimi i jashtëm se sa ata sigurues që janë të vlerësuar me klasifikimin e përgjithshëm 5 apo 4. Gjithashtu, këta sigurues mund të mos jenë në harmoni me rregullat dhe rregulloret. Praktikrat e menaxhmentit të rrezikut mund të jenë më pak të kënaqshme sa i përket madhësisë së siguruesit, ndërlikueshmërisë dhe profilit të rrezikut. Këta sigurues kërkojnë më shumë se mbikëqyrje normale, që mund të përfshinë masat korrigjuese formale ose jo formale. Dështimi duket i pangjashëm, si rezultat i fuqisë së përgjithshme dhe kapacitetit financiar të këtyre siguruesve.

5.1.4 Vlerësimi i përgjithshëm 2 - Siguruesit në këtë grup, në përgjithësi shfaqin praktika apo kushte të pasigurta dhe jo të shëndosha. Ekzistojnë mangësi serioze financiare dhe menaxheriale, të cilat rezultojnë në performancë jo të kënaqshme. Problemet renditen nga dobësi të rënda në kritike. Dobësitë dhe problemet nuk adresohen mjaftueshëm apo nuk zgjidhen nga bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti. Siguruesit në këtë grup, në përgjithësi nuk

janë të aftë që t'i përballojnë një fluksi më të madh të biznesit. Mund të ketë mos pajtueshmëri të theksuar me ligjet dhe rregulloret. Praktikrat e menaxhimit të rreziqeve, në përgjithësi janë të papranueshme, në relacion me madhësinë e siguruesit, ndërlikueshmërinë dhe profilin e rrezikut. Kujdes i madh mbikëqyrës mund të kërkohej, që do të thotë, në shumë raste, veprim formal detyrues është i nevojshëm për të adresuar problemet. Dështimi është një mundësi e dukshme nëse problemet dhe dobësitë nuk adresohen apo zgjidhen në mënyrë të kënaqshme.

5.1.5 Vlerësimi i përgjithshëm 1 – Siguruesit në këtë grup shfaqin praktika apo kushte ekstrem të pa shëndosha dhe pasigurta; shfaqin performancë të mangët kritike, shpesh përmbajnë praktika jo adekuate të menaxhimit të rrezikut në relacion me madhësinë e siguruesit, ndërlikueshmërinë dhe profilin e rrezikut; dhe janë shqetësimet më të mëdha të mbikëqyrësit. Vëllimi dhe ashpërsia e problemeve bie nën përgjegjësinë e tyre, dhe apo mbi aftësitë apo veprimet e menaxhmentit për t'i kontrolluar apo korrigjuar. Ndhmë e menjëhershme financiare e jashtme apo asistencë tjetër nevojitet me qëllim të shpëtimit të siguruesit. Vëmendje e vazhdueshme mbikëqyrëse është e nevojshme. Dështimi është shumë i mundshëm për siguruesit në këtë grup.

5.2. Vlerësimi i komponentëve

5.2.1 Mjaftueshmëria e kapitalit

Vlerësimi 5 - tregon nivele të forta të kapitalit në raport me profilin e rrezikut të siguruesit. Nivelet e kapitalit të siguruesit tejkalojnë kërkesat minimale rregullatore.

Vlerësimi 4 - tregon nivele të kënaqshme të kapitalit në raport me profilin e rrezikut të siguruesit. Nivelet e kapitalit të siguruesit tejkalojnë kërkesat minimale të kërkuara rregullatore.

Vlerësimi 3 - tregon nivele më pak se të kënaqshme të kapitalit, e cila nuk e mbështet plotësisht profilin e rrezikut të siguruesit. Klasifikimi shfaq nevojën për përmirësim, edhe pse niveli i kapitalit të siguruesit tejkalon kërkesat minimale të kërkuara rregullatore.

Vlerësimi 2 - tregon nivele të mangëta të kapitalit. Në lidhje me profilin e rrezikut të siguruesit, mbijetesat e siguruesit mund të kërcënohen. Shtimi i kapitalit nga aksionarët apo burime tjera të jashtme për mbështetje financiare mund të nevojiten. Kapitali i siguruesit është nën nivelet minimale të kërkuara rregullatore.

Vlerësimi 1 - tregon nivele kritike të mungesës së kapitalit, aq sa mbijetesat e siguruesit është fuqimisht e rrezikuara. Kapitali i siguruesit është nën minimumin e kërkuar rregullator. Ndhmë e menjëhershme nga aksionarët apo burime tjera të jashtme për mbështetje financiare është e nevojshme.

5.2.2 Cilësia e asetëve

Vlerësimi 5 – tregon cilësi të fortë të asetëve dhe praktika të forta të menaxhimit të tyre. Dobësitë e identifikuarat janë të vogla dhe ekspozimi ndaj rrezikut kreditor është modest në raport me mbrojtjen e kapitalit dhe aftësitë e menaxhmentit. Cilësia e asetëve në këtë grup të siguruesve ka shqetësim minimal mbikëqyrës.

Vlerësimi 4 - tregon cilësi të kënaqshme të aseteve dhe praktika të mira të menaxhimit të tyre. Niveli dhe ashpërsia e klasifikimeve dhe dobësive tjera justifikojnë nivel të kufizuar të vëmendjes mbikëqyrëse. Ekspozimi i rrezikut është në linjë me kapitalin dhe aftësinë e menaxhmentit.

Vlerësimi 3 - caktohet kur cilësia e aseteve dhe praktikave të menaxhimit të tyre janë më pak se të kënaqshme. Trendët mund të jenë stabil ose tregojnë rënie në cilësinë e aseteve apo një rritje në ekspozimin ndaj rrezikut. Niveli dhe ashpërsia e aseteve të klasifikuara, dobësitë tjera dhe rreziqet kërkojnë një nivel më të lartë të shqetësimit mbikëqyrës. Në përgjithësi, ekziston nevoja e përmirësimit të menaxhimit të aseteve dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut.

Vlerësimi 2 - i caktohet siguruesve me cilësi të dobët të menaxhimit të aseteve apo praktika të dobëta të menaxhimit të tyre. Nivelet e rrezikut dhe asetet me probleme janë të shprehura, të pa kontrolluara në mënyrë adekuate dhe janë subjekt i humbjeve potenciale për siguruesin, të cilat mund ta rrezikojnë qëndrueshmërinë e tij.

Vlerësimi 1 - paraqet dobësi kritike në cilësinë e aseteve apo në praktikave të menaxhimit të tyre, të cilat paraqesin rrezikshmëri të pashmangshme të qëndrueshmërisë së siguruesit.

5.2.3 Risigurimi

Vlerësimi 5 - tregon se siguruesi ka mbulesë ri sigurimi të qëndrueshme dhe kualiteti i rejtungut të ri siguruesve i tejkalon kërkesat e kornizës ligjore. Dobësitë e identifikuara janë të vogla dhe ekspozimi ndaj riskut kreditor, sigurues dhe likuiditetit është modest në raport me mbrojtjen e kapitalit dhe aftësitë e menaxhmentit.

Vlerësimi 4 - tregon se siguruesi ka mbulesë ri sigurimi, kualiteti i rejtungut të ri siguruesit është në pajtim me kërkesat e kornizës ligjore. Mbulesa ri siguruese është e mjaftueshme për rreziqet të cilat mbahen nga siguruesi. Ekspozimi ndaj rreziqeve potenciale është në linjë me kapitalin dhe aftësinë e menaxhmentit.

Vlerësimi 3 - tregon se siguruesi duhet të përmirësoj kualitetin e mbulesës ri siguruese. Mbulesa adekuate ri siguruese mund, në masë të vogël, të mos jetë e mjaftueshme në raport me rreziqet të cilat mbahen nga siguruesi, si dhe vlerësimi i rejtungut të ri siguruesve nuk është në pajtim të plotë me kërkesat e kornizës ligjore. Në përgjithësi, ekziston nevoja e përmirësimit të kualitetit të ri sigurimit dhe praktikave të menaxhimit të rreziqeve.

Vlerësimi 2 - tregon se kualiteti i ri sigurimit është i dobët. Siguruesi nuk posedon mbulesë adekuate ri siguruese për rreziqet të cilat janë marrë në sigurim. Siguruesit me këtë klasifikim mund të karakterizohen me lëkundje dhe menaxhim jo të mirë të rreziqeve të marra në sigurim.

Vlerësimi 1 - tregon se siguruesi ka probleme kritike dhe nuk posedon mbulesë ri sigurimi për rreziqet e marra në sigurim respektivisht për rreziqet e mbajtura. Siguruesit me këtë klasifikim janë të ekspozuar në masë të lartë ndaj rreziqeve të portofolios siguruese.

5.2.4 Mjaftueshmëria e rezervave teknike

Vlerësimi 5 - tregon kualitet të fortë të provizioneve teknike dhe praktika të forta të vlerësimit dhe regjistrimit të tyre. Dobësitë e identifikuar janë të vogla dhe ekspozimi ndaj riskut sigurues, të likuiditetit dhe ligjor është modest në raport me mbrojtjen e kapitalit dhe aftësitë e menaxhmentit.

Vlerësimi 4 - tregon kualitet të kënaqshëm të rezervave teknike dhe praktika të kënaqshme të menaxhimit të tyre. Niveli dhe ashpërsia e klasifikimeve dhe dobësive tjera justifikojnë nivel të kufizuar të vëmendjes mbikëqyrëse. Ekspozimi ndaj rreziqeve është në linjë me kapitalin dhe aftësinë e menaxhmentit.

Vlerësimi 3 - caktohet kur kualiteti i provizioneve teknike dhe praktikave të menaxhimit të tyre janë më pak se të kënaqshme. Trendët mund të jenë stabile ose tregojnë përkeqësim në kualitetin e provizioneve teknike apo një rritje në ekspozimin ndaj rreziqeve. Niveli dhe ashpërsia e provizioneve teknike, dobësitë tjera dhe rreziqet kërkojnë një nivel më të lartë (mesatar) të shqetësimit mbikëqyrës. Në përgjithësi, ekziston nevoja e përmirësimit të menaxhimit të provizioneve teknike dhe praktikave të menaxhimit të rreziqeve.

Vlerësimi 2 - i caktohet siguruesve me kualitet të dobët të menaxhimit të rezervave teknike apo praktika të dobëta të menaxhimit të tyre. Nivelet e rrezikut dhe asetet me probleme janë të shprehura, të pa kontrolluara në mënyrë adekuate dhe janë subjekt i humbjeve potenciale për siguruesin, të cilat mund ta rrezikojnë qëndrueshmërinë e saj.

Vlerësimi 1 - paraqet dobësi kritike të kualitetit të provizioneve teknike apo në praktikave të administrimit të tyre, të cilat paraqesin rrezikshmëri të pashmangshme të qëndrueshmërisë së siguruesit.

5.2.5 Menaxhmenti

Vlerësimi 5 - tregon performancë të fortë nga menaxhmenti dhe bordi drejtues dhe praktika të forta të menaxhimit të rrezikut, në raport me madhësinë e siguruesit, ndërlikueshmërinë dhe profilin e rrezikut. Të gjitha rreziqet e mëdha në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen. Menaxhmenti dhe bordi kanë demonstruar aftësi që shpejt dhe me sukses t'i adresojnë problemet dhe rreziqet e tanishme dhe potenciale.

Vlerësimi 4 - tregon performancë të kënaqshme të menaxhmentit dhe bordit drejtues, dhe praktika të mira të menaxhimit të rrezikut, në relacion me madhësinë e siguruesit, ndërlikueshmërinë dhe profilin e rrezikut. Dobësi të vogla mund të ekzistojnë, por nuk janë materiale për shëndetin dhe sigurinë e siguruesit, nëse adresohen. Në përgjithësi, problemet dhe rreziqet e mëdha identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen në mënyrë efektive.

Vlerësimi 3 - tregon se performanca e menaxhmentit dhe bordit kërkon përmirësim ose praktikave të menaxhimit janë më pak se të kënaqshme, duke marrë për bazë natyrën e aktiviteteve të siguruesit. Aftësitë e menaxhmentit dhe bordit drejtues mund të jenë të pamjaftueshme për llojin, madhësinë apo kushtet e siguruesit. Problemet dhe rreziqet e mëdha nuk janë identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë adekuate.

Vlerësimi 2 - tregon performancë të dobët të menaxhmentit dhe bordit ose praktikave të menaxhimit të rrezikut janë jo adekuate, duke konsideruar natyrën e aktiviteteve të siguruesit. Niveli i problemeve dhe ekspozimit të rrezikut është i tepruar. Problemet dhe rreziqet e mëdha nuk identifikohen, maten, monitorohen apo kontrollohen në mënyrë adekuate dhe kërkojnë veprim të menjëhershëm nga bordi dhe menaxhmenti për të mbrojtur shëndetin e siguruesit. Zëvendësimi apo forcimi i menaxhmentit apo bordit mund të jetë i nevojshëm.

Vlerësimi 1 - tregon dobësi kritike të performancës së menaxhmentit dhe bordit të drejtorëve apo praktikave të menaxhimit të rrezikut. Menaxhmenti dhe bordi drejtues nuk kanë treguar aftësi për të korrigjuar problemet dhe për të zbatuar praktikave të duhura të menaxhimit të rrezikut. Problemet dhe rreziqet e mëdha nuk identifikohen, maten, monitorohen apo kontrollohen në mënyrë adekuate dhe tani rrezikojnë qëndrueshmërinë e vazhdueshme të siguruesit. Zëvendësimi apo forcimi i menaxhmentit apo bordit është i domosdoshëm.

5.2.6 Fitimet

Vlerësimi 5 - tregon se fitimet janë të forta. Fitimet janë më shumë se të mjaftueshme për të mbështetur operacionet dhe të mirëmbajnë nivelin adekuat të kapitalit dhe nivel adekuat të lejimeve (provizioneve), pasi është marrë në konsideratë cilësia e aseteve, rritja dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në kualitetin, sasinë dhe trendin e fitimeve.

Vlerësimi 4 - tregon se fitimet janë të kënaqshme. Fitimet janë të mjaftueshme për të mbështetur operacionet dhe për të mirëmbajtur kapitalin adekuat dhe nivelin e lejimeve (provizioneve), pasi është marrë në konsideratë cilësia e aseteve, rritja dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në kualitetin, sasinë dhe trendin e fitimeve. Fitimet që janë relativisht statike, apo që evidentojnë rënie të lehtë, mund të marrin klasifikimin 4 duke marrë për bazë se niveli i fitimeve të siguruesit është adekuat në funksion të faktorëve të vlerësuar më lartë.

Vlerësimi 3 - tregon se fitimet duhet të përmirësohen. Fitimet mund të mos i mbështesin plotësisht operacionet dhe të përkrahin nivelet e kapitalit dhe lejimeve, në raport me kushtet e përgjithshme të siguruesit, rritjen dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në kualitetin, sasinë dhe trendin e të hyrave.

Vlerësimi 2 - tregon se fitimet janë të dobëta. Fitimet janë të pamjaftueshme për të mbështetur operacionet e siguruesit, dhe për të mbajtur nivele adekuate të kapitalit, si dhe për të mbështetur nivelin e provizioneve. Siguruesit me këtë klasifikim mund të karakterizohen me lëkundje të çrregullta në të hyrat neto dhe margjinën neto të interesit, zhvillimin e ndjeshëm të trendëve negative, fitime nominale apo të paqëndrueshme, humbje me ndërprerje apo rënie thelbësore në fitime nga vitet paraprake.

Vlerësimi 1 - tregon se fitimet janë kritike të dobëta. Siguruesi me fitime të klasifikuara 1 është duke përjetuar humbje, që paraqesin rrezik të dukshëm për qëndrueshmërinë e tij nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit.

5.2.7 Likuiditeti

Vlerësimi 5 - tregon nivele të forta të likuiditetit dhe praktika mirë të zhvilluara të menaxhimit të aseteve. Siguruesi ka qasje të lehtë në burime të mjaftueshme të fondeve në kushte të favorshme për të përmbushur nevojat e tanishme dhe të ardhshme të likuiditetit.

Vlerësimi 4 - tregon nivele të kënaqshme të likuiditetit dhe praktika të kënaqshme të menaxhimit të fondeve. Siguruesi ka qasje të lehtë në burime të mjaftueshme të fondeve me kushte të pranueshme për të përmbushur nevojat e tanishme dhe të ardhshme të likuiditetit. Dobësi modeste mund të jenë evidente në praktikatat e menaxhimit të fondeve.

Vlerësimi 3 - tregon nivele apo praktika të menaxhimit të fondeve që kanë nevojë për përmirësim. Siguruesit me klasifikim 3 mund të kenë mungesa në qasje të fondeve me kushte të arsyeshme apo mund të kenë dobësi të theksuara në praktikatat e menaxhimit të fondeve.

Vlerësimi 2 - tregon dobësi në nivelet e likuiditetit apo praktika jo adekuate të menaxhimit të fondeve. Siguruesit me klasifikim 2 mund të mos jenë në gjendje për të marrë nivelin e mjaftueshëm të fondeve me kushte të arsyeshme për të përmbushur nevojat e likuiditetit.

Vlerësimi 1 - tregon se nivelet e likuiditetit apo praktikatat e menaxhimit të fondeve janë kritike/të dobëta sa që qëndrueshmëria e vazhdueshme e siguruesit është rrezikuar. Siguruesit me klasifikim 1 kërkojnë ndihmë financiare të jashtme të menjëhershme për detyrimet e maturuara apo nevoja tjera të likuiditetit.

5.2.8 Rreziku i tregut

Vlerësimi 5 - tregon se menaxhmenti në mënyrë efektive identifikon dhe kontrollon rrezikun ndaj normave të interesit, që rrjedh nga aktivitetet e institucionit, duke përfshirë edhe ato nga produktet e reja;

Vlerësimi 4 - tregon se menaxhimi i rrezikut ndaj normave të interesit të institucionit është shumë efektiv, por me mangësi në një shkallë modeste. Ajo pasqyron përgjegjshmërinë dhe aftësinë për t'u përballur me sukses me ekspozimet ekzistuese dhe të parashikueshme, që mund të lindin gjatë kryerjes së planit të biznesit të institucionit. Derisa institucioni mund të ketë disa dobësi të vogla të menaxhimit të rrezikut, këto probleme mund të janë pranuar dhe janë adresuar. Në përgjithësi, rreziqet kontrollohen në atë mënyrë që nuk kërkon vëmendje shtesë apo më shumë se normale nga mbikëqyrësi.

Vlerësimi 3 - do të thotë që praktikatat e menaxhimit të rrezikut ndaj normave të interesit që janë të mangëta në disa pjesë të rëndësishme, dhe për këtë arsye, janë shkas për vëmendje më tepër se normale nga ana e mbikëqyrësit. Një apo më shumë nga katër elementet e menaxhimit të shëndoshë të rrezikut ndaj normave të interesit janë konsideruar fer dhe kanë penguar institucionin për të adresuar tërësisht rrezikun e rëndësishëm të operacioneve të saj. Praktika të posaçme të menaxhimit të rrezikut është e nevojshme të përmirësohen për t'u siguruar se menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve janë në gjendje të identifikojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë në mënyrë adekuate të gjitha rreziqet e rëndësishme të institucionit.

Vlerësimi 2 - paraqet dobësi në praktikatat e menaxhimit të rrezikut ndaj normave të interesit, të cilat në përgjithësi dështojnë të identifikojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë ekspozimet e

rreziqeve kryesore në shumë aspekte materiale. Në përgjithësi, një situatë e tillë reflekton mangësi në udhëzime dhe mbikëqyrje adekuate nga menaxhmenti dhe bordi. Një apo më shumë nga katër elementet e menaxhimit të shëndoshë të rrezikut ndaj normave të interesit janë konsideruar të dobëta dhe kërkojnë veprim dhe korrigjim të menjëhershëm nga ana e bordit dhe menaxhmentit.

Vlerësimi 1 - tregon mungesë kritike të praktikave efektive të menaxhimit të rrezikut, për të identifikuar, monitoruar apo kontrolluar ekspozimet e rreziqeve kryesore. Një apo më shumë nga katër elementet e menaxhimit të shëndoshë të rrezikut ndaj normave të interesit janë konsideruar tërësisht të mangëta, ku menaxhmenti dhe bordi nuk kanë demonstruar aftësi për të adresuar mangësitë. Mangësitë në procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe kontrolleve të brendshme të institucionit kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe të afërt nga mbikëqyrësi.

6. Përcaktimi i shpeshtësisë së ekzaminimit

Siguresit do të klasifikohen në katër zona të ndara, sipas vlerësimit të tyre përfundimtar në bazë të vlerësimit dhe drejtimit të rrezikut: Zona e bardhë, zona e verdhë, zona portokalli, zona e kuqe. Secila zonë duhet të mundësojë ciklin e ekzaminimit, intensitetin e ekzaminimit të siguresit relevantë, qëndrimin e BQK-së ndaj siguresit relevante, si dhe metodat e aplikimit që duhet të zbatohen.

Një cikël i ekzaminimit përbëhet nga periudhat nga 6 deri në 30 muaj, të cilat përcaktohen sipas zonave në të cilat ato janë ndarë.

Zona e bardhë: Siguresit që kanë vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut “1” përfshihen në zonën e bardhë dhe këta siguresit kërkojnë aktivitete të rralla të ekzaminimit. Cikli i ekzaminimit përcaktohet të jetë më së paku 30 muaj. Aktiviteti në nivel të ulët i ekzaminimit konsiderohet si adekuat.

Zona e gjelbër: Siguresit që kanë vlerësimin e përgjithshëm “2” përfshihen në zonën e gjelbër dhe këta siguresit janë subjekt i aktiviteteve të ekzaminimit nga mbikëqyrja në vend së paku një herë në 20 muaj.

Zona portokalli: Siguresit që kanë vlerësimin e përgjithshëm “3” përfshihen në zonën portokalli. Tek këta siguresit aplikohet ekzaminim intensiv. Cikli i ekzaminimit është përcaktuar të jetë në së paku çdo 12 muaj. Duhet të aplikohet një program parandalues dhe korrigjues në siguresit për përmirësimin e kontrolleve dhe menaxhimin e profilit të rrezikut nga ana e siguresit në pajtim me kapacitetin rrezikmbajtës.

Zona e kuqe: Siguresit që kanë vlerësimin e përgjithshëm “4” përfshihen në zonën e kuqe. Tek këta siguresit aplikohet ekzaminim intensiv. Cikli i ekzaminimit është përcaktuar të jetë ndërmjet 0 deri në 6 muaj dhe kërkohet veprim i menjëhershëm korrigjues për përmirësimin e profilit të rrezikut të siguresit¹. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut sipas të cilit caktohet shpeshtësia e ekzaminimeve është paraqitur si në vijim:

Vlerësimi i Përgjithshëm i Rrezikut	Zona	Shpeshtësia e ekzaminimit
1	Zona e bardhë	Së paku në çdo 30 muaj
2	Zona e gjelbër	Së paku në çdo 18 muaj
3	Zona portokalli	Së paku në çdo 12 muaj
4	Zona e kuqe	Së paku në çdo 6 muaj

¹ Sipas vlerësimit dhe proceseve mbikëqyrëse vendoset nevoja për ekzaminime të plota, me fushëveprim të kufizuar ose përcjellja e përafërt e gjendjes së siguresit nga jashtë, duke përfshirë analizat nga “Off-Site”.

7. Faza e katërt: Letrat e punës së ekzaminimit

Letrat e punës do të jenë një pjesë e rëndësishme e procesit të ekzaminimit në vend si dhe do të demonstrojnë profesionalizmin e DMS-së dhe qasjen e disiplinuar. Gjetjet e rëndësishme, analizat logjike, si dhe konstatimet përfundimtare mund të jenë të padobishme pa një dokumentacion të qartë. Letrat e punës do të jenë bazamenti i raportit të ekzaminimit në vend, prandaj, koha që kalohet në përgatitjen e dokumenteve të punës paraqet një investim të mirë në procesin e ekzaminimeve në vend.

DEFINICIONI I LETRAVE TË PUNËS

Një dokument i përgatitur ose i siguruar nga ekzaminuesit në vend dhe që ofron dëshmi relevante në përkrahje të një hapi të programit të ekzaminimit në vend. Përveç kësaj, dokumenti mund të shërbej si bazë për përfundimet dhe rekomandimet që janë pjesë e raportit të ekzaminimit në vend. Secili dokument i punës është një pjesë e rëndësishme e grumbullit të dokumenteve të punës (administrative, fushat e ekzaminimit, përcjelljet, raporti) që përkrahin tërësinë e programit të ekzaminimit në vend.

Plotësimi dhe aranzhimi i dokumenteve duhet të bëhet sipas një metode logjike të punës, për të siguruar shfrytëzimin maksimal të materialit, në mënyrë që të lehtësohet kontrolli dhe shqyrtimi i dosjeve dhe përgatitja e raportit të ekzaminimit në vend. Konsistenca në përgatitjen dhe organizimin e letrave të punës të ekzaminimit është një pjesë e rëndësishme e një ekzaminimi në vend të kryer mirë. Sistemi i vendosjes së numrave për dokumentet e punës duhet të jetë mjaftë fleksibil për të plotësuar nevojat e shumicës së ekzaminimeve në vend si dhe të ofrojë uniformitet të kërkuar për qëllime të shqyrtimit dhe kontrollimit.

Letrat e punës duhet të jenë të qarta, koncize dhe të kuptueshme. Personeli i BQK-së duhet ta ketë parasysh se persona tjerë mund të ekzaminojnë ose t'i referohen dosjeve përfshirë këtu auditorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Kushdo që shqyrton dokumentet e punës, pa iu referuar dokumenteve jashtë atyre të përfshira në dokumentet e punës dhe pa bërë pyetje, duhet të jetë në gjendje që të kuptojë se çfarë ka dashur të bëjë ekzamineri, çfarë ka bërë, çfarë kanë gjetur dhe në çfarë përfundimi kanë arritur.

1. Aspektet e rëndësishme

Aspektet e rëndësishme të dokumenteve të punës do të përfshijnë:

- Qëllimet, fushëveprimin dhe metodologjinë, përfshirë këtu çfarëdo kriteri të përzgjedhjes së mostrave;
- Dokumentacionin e punës së kryer në mbështetje të përfundimeve dhe gjykimeve të rëndësishme, përfshirë këtu përshkrimin e transaksioneve dhe shënimeve të ekzaminuara që do të mundësonin të kuptuarit e tyre.
- Dëshmi mbi shqyrtimet e punës së kryer.

2. Udhëzimet e përgjithshme

Udhëzimet e përgjithshme për atë se çfarë do të duhej të përmbanin dokumentet punës janë si në vijim:

- Dokumentimi i informatave të marra për fushën që është duke u shqyrtuar;
- Dokumentacion mbështetës për gjetjet dhe rekomandimet që janë pjesë e raportit të ekzaminimit në vend;
- Uniformiteti i procesit të ekzaminimit në vend;
- Udhëzues i ekzaminimeve të ardhshme në vend;
- Dokumentet e punës duhet të jenë të plota, të sakta dhe të mbështesin observimet, testimet, përfundimet dhe rekomandimet. Ato gjithashtu duhet të tregojnë natyrën dhe fushëveprimin e punës së kryer.
- Dokumentet e punës duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme pa pasur nevojë për shpjegim shtesë verbal.
- Informatat që gjenden në dokumentet e punës duhet të jenë të kufizuara në çështjet që janë të rëndësishme dhe të nevojshme për të mbështetur qëllimet dhe fushëveprimin e përcaktuar për atë detyrë; dhe
- Dokumentet e punës duhet të jenë të lexueshme sa më mirë.

Dokumentet e punës duhet të organizohen në një mënyrë logjike dhe uniforme. Sistemi i indeksimit duhet të jetë i dizajnuar në mënyrë që të përcjell një sekuencë kronologjike të ekzaminimit.

3. Shqyrtimi i dokumenteve të punës

Të gjitha dokumentet e punës duhet të shqyrtohen nga udhëheqësi i ekipit të ekzaminimit apo dikush tjetër i rekomanduar nga udhëheqësi i ekipit.

Dokumentet e punës shqyrtohen për një numër të arsyeve përfshirë këtu: sigurimi se ekzaminimi është kryer në pajtim me standardet dhe proceset e caktuara për përgatitjen e dokumenteve të punës për të siguruar se:

- Ka pasur konsistencë të standardeve të pritura;
- Ka pasur kujdes të duhur dhe gjykim profesional;

- Konfirmim se puna e menduar për ekzaminim është kompletuar;
- Konfirmim se dëshmitë e mbledhura dhe analizuara kanë dhënë mbështetje për përfundimet e arritura; dhe
- Sigurimi se të gjitha rreziqet e rëndësishme, çështjet, observimet dhe brengat e ngritura (përfshi këtu parregullsitë e mundshme) gjatë ekzaminimit në vend janë trajtuar në mënyrën e duhur.

Një rezultat shumë i rëndësishëm dytësor i shqyrtimit të dokumenteve të punës të përgatitura është mundësia që ato ofrojnë udhëzimin e ekzaminerëve të rinjë në vendin e punës.

Dokumentet e punës duhet të shqyrtohen nga udhëheqësi i ekipit pasi të kompletohen nga ekzamineret dhe sidomos pasi që puna në terren e ekzaminimit të jetë kompletuar.

Forma dhe përmbajtja e detajuar e letrave të punës do të përcaktohet për zbatimin e këtij manuali.

8. Faza e pestë – Raportimi

Hapi final është komunikimi i gjetjeve dhe rekomandimeve për siguruesin e ekzaminuar dhe ndërmarrja e hapave vijuese për çfarëdo veprimi mbikëqyrës apo plani të veprimit për të cilin është marrë vendimi. Raporti i ekzaminimit duhet t'ia komunikoj në mënyrë të qartë dhe koncize bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të siguruesit çfarëdo çështje mbikëqyrëse, mos-përbushje të ligjeve dhe rregulloreve, probleme apo parregullësi të identifikuara që kanë të bëjnë me siguruesin dhe duhet ta shpalos notimin e procesit të vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut të siguruesit.

Procesi i hartimit të draft raportit, dorëzimit dhe finalizimit të raportit të hartuar nga DMS-ja do bëhet në pajtim me nenin 89, Raporti i ekzaminimit të Ligjit Nr. 05/L -045 për Sigurime si dhe aktet tjera përkatëse.

8.1. Shabllonet e raportimit

Për dokumentimin e gjetjeve të ekzaminimit në vend/hartimin e raporteve të ekzaminimit në varësi të fushëveprimit duhet të përdoren dy shabllone të raportimit, njëri për ekzaminimin e plotë në vend dhe tjetri për ekzaminimin me fushëveprim të kufizuar në vend.

Shembulli i formatit të raportit të ekzaminimit të plotë është dhënë më poshtë në Shtojcën 2, ndërsa formati i ekzaminimit me fushëveprim të kufizuar do të jetë dinamik në varësi të fushëveprimit.

SHTOJCA 2 – Mostër (shembull) i formës së raportit të ekzaminimit

RAPORT I EKZAMINIMIT	
Emri i siguruesit:	
Adresa:	Rr." Xxxxx" Nr.xx. Prishtinë, Kosovë
Informatat financiare të datës:	data muaji viti
Data e fillimit të ekzaminimit:	data muaji viti
Data e përfundimit të ekzaminimit:	data muaji viti
Ekzaminer përgjegjës: ²	Emri i ekzaminerit përgjegjës, Pozita në punë

KY RAPORT I EKZAMINIMIT ËSHTË KONFIDENCIAL

Ky raport i ekzaminimit është pronë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), dhe përmbajtja e saj është konfidenciale. Zbulimi i paautorizuar i përmbajtjes së këtij raporti, duke përfshirë komponentët dhe vlerësimin e përgjithshëm, është i ndaluar. Informacioni mund t'i

² Ekipi i ekzaminerëve të BQK-së (përveç ekzaminerit përgjegjës): xxx XXXX (ekzaminerë të lartë të sigurimeve); xxx XXXX (ekzaminerë i sigurimeve); xxx XXXX (ekzaminerë i ri i sigurimeve).

shpaloset kompanisë pronare të siguruesit. Çfarëdo shpalosje e informatave apo përmbajtjes së raportit të ekzaminimit, pa miratimin paraprak të BQK-së është i ndaluar. Informatat në këtë raport janë të bazuara në librat dhe regjistrat e siguruesit, deklaratat e bëra nga ana e drejtorëve, zyrtarëve dhe punonjësve tek ekzaminuesi dhe informatat e marra nga burimet e tjera në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-045 mbi Sigurimet.

Ky raport i ekzaminimit nuk është auditim i siguruesit dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë. Ky ekzaminim nuk i liron drejtorët nga përgjegjësit e tyre për kryerjen apo sigurimin e auditimeve adekuate të siguruesit. Secili drejtor, në mënyrë që t'ju përmbahet përgjegjësive të tij apo saj ndaj polic mbajtësve dhe aksionarëve, duhet të rishikoj këtë raport. Pas rishikimit, bordi i drejtorëve duhet të nënshkruaj formën e bashkëngjitur në këtë raport.

1. INFORMATA MBI HISTORIKUN

1.1. Informata për siguruesin

Xxxx

1.2. Fushëveprimi i ekzaminimit

Xxxx

1.3. Takimi përmbyllës i ekzaminimit

Xxxx

1.4. KOMENTET PËRFUNDIMTARE TË EKZAMINIMIT

Gjatë ekzaminimit janë identifikuar **çështjet të cilat kërkojnë vëmendje**, të cilat janë të listuara si në vijim: (për informata shtesë shiko pjesën e vlerësimit individual të raportit sipas rreziqeve):

1. Xxx;

2. Xxx;

3. Xxx ETJ.

2. VLERËSIMI I RREZIKUT DHE PËRMBLEDHJA E KLASIFIKIMIT

Xxxx

2.1. Rreziku qeverisës

Xxxx

2.2. Rreziku strategjik

Xxxx

2.3. Rreziku sigurues

XXXX

2.4. Rreziku kreditor

XXXX

2.5. Rreziku i likuiditetit

Xxxx

2.6. Rreziku operacional

Xxxx

2.7. Rreziku ligjor

XXXX

2.8. Rreziku i tregut

XXXX

3. FUNKSIONET E KONTROLLIT PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT**3.1. Kontrollat e brendshme**

XXXX

3.2. Auditimi i Brendshëm

XXXX

3.3. Menaxhmenti i lartë

XXXX

3.4. Mbikëqyrja nga Bordi

XXXX

3.5. Menaxhimi i rrezikut

XXXX

3.6. Menaxhimi i Pajtueshmerisë

XXXX

3.7. Analizat financiare

XXXX

3.8. Teknologjia Informativë

XXXX

3.9. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve

XXXX

XXXX XXXX

XXXX XXXX

XXXX XXXX

Mbikëqyrës i Lartë
i SigurimeveUdhëheqës i Divizionit
të Mbikëqyrjes në VendDrejtore i Departamentit të
të Mbikëqyrjes së Sigurimeve

3.10. ÇËSHTJET QË KËRKOJNË VËMENDJE

Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i siguruesit janë përgjegjës për sigurimin e korigjimit të çështjeve të listuara brenda afateve të përcaktuara kohore si në vijim:

Pajtueshmëria e plotë me rregulloret e BQK-së të shpalosura tek pjesa e shkeljeve.

Janë evidentuar një numër i mos pajtueshmërisë me rregulloret e BQK-së.

Rekomandim

Të sigurojë pajtueshmëri të plotë me rregulloret e BQK-së, të shpalosura tek pjesa e shkeljeve.

Afati kohor për veprim korigjues

dd ditë nga marrja e raportit të ekzaminimit.

Pajtueshmëria e plotë me rregulloret e BQK-së të shpalosura tek pjesa e shkeljeve.

Janë evidentuar një numër mos pajtueshmërisë me rregulloret e BQK-së.

Rekomandim

Të sigurojë pajtueshmëri të plotë me rregulloret e BQK-së, të shpalosura tek pjesa e shkeljeve

Afati kohor për veprim korigjues

dd ditë nga marrja e raportit të ekzaminimit.

4. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMEVE TË RREZIQEVE

4.1. MATRICA E RREZIKUT DHE PËRSHKRIMI I VLERËSIMIT TË RREZIQEVE

Profili i Rrezikut të Siguruesit				
Kategoria e Rrezikut	Sasia e Rrezikut të Qenësishëm (i ultë, mestar, mbi mesatare, i lartë)	Kualiteti i Menaxhimit të Rrezikut (i dobët ,i pranueshëm, nevojë për përmirësim, i fortë)	Niveli i Rrezikut të përgjithshëm (i ultë, mestar, mbi mesatare, i lartë))	Drejtimi i Rrezikut (në rritje ↑ stabil ↔ në rënie ↓)
Rreziku i Përgjithshëm	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku qeverisës	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku strategjik	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku sigurues	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku kreditor	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku i likuiditetit	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku operacional	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku ligjor	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx
Rreziku i tregut	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx

Fushëveprimi

Xxxx

Konkluzionet për rrezikun e përgjithshëm

Xxxx (shiko përmbledhjen e vlerësimit të rrezikut dhe pjesën e rreziqeve individuale në këtë raport).

Rreziku qeverisës

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut qeverisës në këtë raport).

Rreziku strategjik

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut strategjik në këtë raport).

Rreziku sigurues

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut sigurues në këtë raport).

Rreziku kreditor

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut kreditor në këtë raport).

Rreziku i likuiditetit

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit në këtë raport).

Rreziku operacional

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut operacional në këtë raport).

Rreziku ligjor

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut ligjor në këtë raport).

Rreziku i tregut

Xxxx (shiko seksionin e vlerësimit të rrezikut të tregut në këtë raport).

5. VLERËSIMI SIPAS METODOLOGJISË “CARMELS”

	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
Data e fillimit të ekzaminimit	Data muaji viti	Data muaji viti	Data muaji viti
Data e përfundimit të ekzaminimit	Data muaji viti	Data muaji viti	Data muaji viti
Informatat financiare të datës:	Data muaji viti	Data muaji viti	Data muaji viti
Vlerësimi i Përgjithshëm	X	X	X
Vlerësimi i komponentëve:			
Mjaftueshmëria e kapitalit	X	X	X
Cilësia e aseteve	X	X	X
Risigurimi	X	X	X
Kalkulimet aktuariale dhe mjaftueshmërinë e rezervave teknike	X	X	X
Menaxhmenti	X	X	X
Fitimet	X	X	X
Likuiditeti	X	X	X
Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut	X	X	X

Sistemi i Vlerësimit “CARMELS” të Siguruesit

Konkluzionet lidhur me kushtet e përgjithshme të siguruesit janë të përmbledhura në klasifikimin përbërës që përfaqëson vlerësimin e përgjithshëm të tetë fushave kryesore të përfshira në sistemin e klasifikimit CARMELS. Këta faktorë përbërës adresojnë mjaftueshmërinë e kapitalit, kualitetin e aseteve, risigurimin, kalkulimet aktuariale dhe rezervat teknike, menaxhmentin, fitimet, mjaftueshmërinë e likuiditetit dhe ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut. Vlerësimi i përbërësve ka për konsideratë madhësinë e institucionit, natyrën dhe ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të tyre dhe profilin e rrezikut.

Përbërja dhe komponentët e klasifikimit janë përcaktuar bazuar në shkallë numerike prej 1 deri 5. Numri 5 tregon klasifikimin më të lartë, performancë më të fortë dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut dhe shkallën më të vogël të brengosjes së mbikëqyrjes, përderisa numri 1 tregon klasifikimin më të ulët, performancë më të dobët, praktika jo të mjaftueshme të menaxhimit të rrezikut dhe si pasojë shkallën më të lartë të shqetësimit mbikëqyrës

Vlerësimi i Përgjithshëm: X

(Paraqitet pjesa e manualit me notën sipas Vlerësimit të përgjithshëm)

1.1. MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

1.1.1. Vlerësimi i komponentës CARMELS /Kapitali:

XXXXXXXX

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti
Vlerësimi i kapitalit	X	X	X
Neto primet (primi i mbajtur) / Gjithsej Ekuiteti			
Bruto primet / Gjithsej Ekuiteti			
Kapitali / Total Asetet			
Kapitali / Provizionet teknike			
Koeficienti i aftësisë paguese (Solvences)			
Kapitali / Fondi Garantues			
ROAE			
... / (1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.1.2. Fushëveprimi

XXX.

1.1.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

XXX.

1.2. CILËSIA E ASETETEVE

1.2.1. Vlerësimi i komponentës CARAMELS / Kualiteti i asetëve: (X)

Xxxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti	Data/muaji/ viti
Vlerësimi i kualitetit të asetëve	X	X	X
((Asetet Fikse+ asetet e paprekshme + shpenzimet e shtyra + të arkëtueshmet) / Total asetet)			
Debitorët e Primeve / Bruto primet e shkruara			
Të arkëtueshmet / Gjithsej Asetet			
Të arkëtueshmet / Gjithsej Ekuiteti			
Të arkëtueshmet tjera / Gjithsej të arkëtueshmet			
... / (1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.2.2. Fushëveprimi

Xxxx.

1.2.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx

1.3. RISIGURIMI

1.3.1. Vlerësimi i komponentës CARAMELS / Risigurimi: (X)

Xxxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti
Vlerësimi i komponentes së ri sigurimit	X	X	X
Raporti i komisioneve të Ri sigurimit			
Neto Primet / Bruto primet			
Pjesa e ri siguresit në shumën e sigurimit/total shuma e sigurimit x 100			
Niveli i koncentrimit të ri siguresve sipas shumave të sigurimit			
Shuma e ri siguruar, transferuar te ri siguresit e qëndrueshëm/gjithsej shuma e siguruar x 100			
... / (1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.3.2. Fushëveprimi

Xxxx.

1.3.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx

1.4. KALKULIMET AKTUARIALE DHE MJAFTUESHMËRIA E REZERVAVE TEKNIKE**1.4.1. Vlerësimi i komponentës CARAMELS / Adekuatshmeria e provizioneve teknike: (X)**

Xxxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti	Data/muaji/viti
Vlerësimi i komponentes së adekuatshmërisë së provizioneve teknike	X	X	X
Provizionet teknike neto/mesatarja e dëmeve neto të paguara në 3 vitet e fundit			
Provizionet teknike neto/mesatarja e primit neto të pranuar në 3 vitet e fundit			
.../(1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.4.2. Fushëveprimi

Xxxx.

1.4.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx

1.5. MENAXHMENTI

1.5.1. Vlerësimi i komponentës CARAMELS / Menaxhmenti/ Qeverisja: (X)

Xxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/ viti	Data/muaji/ viti
Qëndrueshmëria e menaxhmentit	X	X	X
Gjithsej primet e shkruara (në mijë) / Numri i punonjësve			
Gjithsej Asetet (në mijë) / Numri i punonjësve			
Raporti i Komisioneve ndaj Bruto primeve të shkruara			
... / (1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.5.2 Fushëveprimi

Xxx.

1.5.3 Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxx.

1.6. FITIMET

1.6.1. Vlerësimi i komponentës CARAMELS /Fitimet: (X)

Xxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/ viti	Data/muaji/ viti	Data/muaji/viti
Vlerësimi i fitimeve	X	X	X
Neto Humbjet e ndodhura/ Neto primet e fituara			
Shpenzimet administrative / Neto primet e fituara			
Të hyrat neto nga investimet / Neto primet e fituara			
Raporti i kombinuar			
Raporti operativ			
Të hyrat neto nga investimet / Mesatarja e aseteve të investuara			
ROAA (Neto fitimi & humbja / gjithsej mesatarja e aseteve)			
Neto fitimi & humbja (në mijë euro) /Numri i punonjësve			
... / (1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.6.2. Fushëveprimi

Xxxx.

1.6.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

1.7. LIKUIDITETI**1.7.1. Vlerësimi i komponentës CAMELS /Likuiditeti: (X)**

Xxxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/ viti	Data/muaji/ viti
Vlerësimi i komponentes së likuiditetit	X	X	X
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë ndaj gjithsej asetëve			
Përshkrimi i asetëve ndaj provizioneve teknike			
Investimet në depozita ndaj gjithsej asetëve			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë+ investimet afatshkurta+ llogaritë e arkëtueshme/detyrimet afatshkurta			
Asetet afatshkurtra-detyrimet afatshkurtra			
.../(1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.7.2. Fushëveprimi

Xxx.

1.7.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

1.8. NDJESHMËRIA NDAJ RREZIKUT TË TREGUT

1.8.1. Vlerësimi i komponentës CAMELS/Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut: (X) Xxxx.

TREGUESIT (%)	Ekzaminimi aktual	Ekzaminimi paraprak	Ekzaminimi paraprak
	Data/muaji/viti	Data/muaji/ viti	Data/muaji/ viti
Vlerësimi i komponentes së likuiditetit	X	X	X
Pozicionet bruto në valutë të huaj ndaj ekuitetit			
Treguesi i GAP			
.../(1)

Shënim: (1) Tregues të tjerë të rëndësishëm sipas nevojës;

1.8.2. Fushëveprimi

Xxxx.

1.8.3 Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.1. RREZIKU OPERACIONAL

2.1.1. Vlerësimi i rrezikut operacional

Xxx.

Kategoria e Rrezikut	Sasia e Rrezikut të Qenësishëm (i ultë, mestar, mbi mesatare, i lartë)	Kualiteti i Menaxhimit të Rrezikut (i dobët, i pranueshëm, nevojë për përmirësim, i fortë)	Niveli i Rrezikut të përgjithshëm (i ultë, mestar, mbi mesatare, i lartë)	Drejtimi i Rrezikut (në rritje ↑ stabil ↔ në rënie ↓)
Rreziku Operacional	Xxxx	Xxxx	Xxxx	Xxxx

2.1.2 Fushëveprimi

Xxxx.

2.1.3 Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.2. KONTROLLET E BRENDSHME

2.2.1. Fushëveprimi

Xxxx.

2.2.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx

2.2.3. AUDITIMI I BRENDSHËM

2.2.4 Fushëveprimi

Xxxx

2.2.5. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx

2.2.6. Komiteti i auditimit

Xxxx.

2.2.7. AUDITIMI I JASHTËM

Xxxx.

2.3. MENAXHMENTI I LARTË

2.3.1. Fushëveprimi

Xxxx.

2.3.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.4. MBIKËQYRJA NGA BORDI

2.4.1. Fushëveprimi

Xxxx.

2.4.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.5. MENAXHIMI I RREZIKUT

2.5.1. Fushëveprimi

Xxxx.

2.5.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.6. MENAXHIMI I PAJTUESHMERISE

2.6.1. Fushëveprimi

Xxxx.

2.6.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.7. ANALIZAT FINANCIARE

2.7.1. Fushëveprimi

Xxxx.

2.7.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

2.8. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

2.8.1. Fshëveprimi

Xxxx.

2.8.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

Xxxx.

3. SHKELJET E LIGJEVE DHE RREGULLOREVE

- Ligjin Nr. 04/L-45 për Sigurimet.

Rregullore për xxx

Neni X: Xxxx, paragrafi 1

1. Xxx

Rregullorja për xxx

Neni X: Xxxx, paragrafi X

4. Xxxx:

a. Xxx;

4. SHTOJCAT

5. Nënshkrimi i antarëve të bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv

Ne anëtarët e bordit të drejtorëve dhe kryeshefi ekzekutiv të poshtëshënuar të siguruesit Xxx personalisht e kemi shqyrtuar përmbajtjen e Raportit të Ekzaminimit të datës *data/ muaji/viti*.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi	Datë
1.	Xxx XXXX-kryetar		
2.	Xxx XXXX		
3.	Xxx XXXX		
4.	Xxx XXXX		
5.	Xxx XXXX		
6.	Xxx XXXX -kryeshef ekzekutiv		

SHËNIM: Ky formular duhet të mbetet i bashkangjitur me Raportin e Ekzaminimit dhe duhet të ruhet në dosjen e siguruesit për shqyrtim gjatë ekzaminimeve pasuese.

9. Hyrja në fuqi

Ky manual do të jetë efektiv nga data 01 janar 2020.

Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org